

URTËSIA

REVISTË FETARE, SHOQËRORE, ARTISTIKE.

BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË

KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE.

NR. 162 / JANAR-SHKURT / 2025



PËRCILLET NGA KJO JETË, BABA HEKURAN NIKOLLARI

[illegible][illegible]

PËRGATITËN REVISTËN:
-KUJTIM BORIÇI
-NURI ÇUNI
-SHELDIANA JANO
FOTOGRAF: NURI ÇUMANI

Kontaktet me redaksinë:
Email: revista.urtesia@yahoo.com
 Nr. 162 / Special 2025

PRINTOHET NË
SHTYPSHKRONJËN
"URTËSIA BEKTASHIANE"

[illegible]

FAQE 38

FAQE 25

Tarikati bektashian nuk është përhapur veçse në territorin e Perandorisë otomane (në Anadoll, në vendet ballkanike, në Kretë dhe në Egjipt), ndryshe nga Urdhrat e tjera mistike, përhapja e të cilave preku një hapësirë të qjerë gjeografike...

Ditën e enjte, më 27 shkurt 2025, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij Haxhi, Dede Baba, Edmond Brahimaj, zhvilloi një takim të nivelit të lartë me drejtuesit e kabinetit të z. Antonio Costa...

Në brendësi:



NDËRROI JETË BABA HEKURAN NIKOLLARI. CEREMONIA E LAMTUMIRËS, U BË NË TEQENË E ALIPOSTIVANIT-PËRMET

Nga Nuri ÇUNI

Në datën 3 shkurt 2025, në teqenë e Alipostivanit-Përmet, kaloi nga jeta baba Hekuran Nikollari. Pritja dhe homazhe u bënë në datat 4-5 shkurt 2025, në teqenë e Alipostivanit. Varrimi u bë ditën e enjte, 6 shkurt 2025, ora 12.00, po në teqenë e Alipostivanit, Përmet.

FAQE 4-5



14-17 JANAR, PËRVJETORI I 104 I MBAJTJES SË KONGRESIT TË PARË BEKTASHIAN

Nuri ÇUNI

Periodha 14-17 janar e këtij viti, ishte një ngjarje e shënuar përkujtimore, për besimtarët bektashian në Shqipëri dhe në botë, pasi plot 104 vjet më parë, të teqenë e njohur të Prishtës në Skrapar, u mbajt Kongresi i Parë Bektashian, që njihet si 'Kongresi i Prishtës'. Ky kongres, mori vendime tejet të rëndësishme. Kjo ngjarje përkujtohet në të gjitha institucionet bektashiane. "...Kongresi i Parë Bektashian e Prishtës, është një ngjarje me rëndësi në historinë e bektashizmit.

FAQE 10-11



KONTRIBUTI I KLERIT BEKTASHIAN NË ÇLIRIMIN E ATDHEUT- RASTI I DEDE AHMETIT

Haxhi Dede Baba, Edmond BRAHIMAJ
Kryegjysh Botëror i Bektashizmit

Jam i nderuar që sot do të kumtoj në ligjëratën time për një figurë të lartë të bektashizmit Shenji Dede Ahmed Myftari, klerik patriot, atdhetar, paqedashës. Kontributi i klerit bektashian është parë në të gjithë vijën e historisë së njerëzimit. Kjo ka filluar me masakrën e parë, që ka ndodhur me Sulltan Mahmutin e Dytë...

FAQE 26-27



Nga ceremonia e përcjelljes së baba Hekuranit

NDËRROI JETË BABA HEKURAN NIKOLLARI. CEREMONIA E LAMTUMIRËS, U BË NË TEQENË E ALIPOSTIVANIT-PËRMET

Nga Nuri ÇUNI

Në datën 3 shkurt 2025, në teqenë e Alipostivanit-Përmet, kaloi nga jeta baba Hekuran Nikollari. Pritja dhe homazhe u bënë në datat 4-5 shkurt 2025, në teqenë e Alipostivanit. Varrimi u bë ditën e enjte, 6 shkurt 2025, ora 12.00, po në teqenë e Alipostivanit, Përmet.

CEREMONIA

Me prezencë të qindra besimtarëve bektashianë, klerikëve, nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut e Kosova,



Baba Hekuran Nikollari

deputetëve, funksionarëve shtetërorë, vendorë, nën drejtimin e Kryegjyshit Botëror Bektashian, Haxhi Dede Baba, Edmond Brahimaj, mesditën e së mërkurës, në Teqenë e Alipostivanit-Përmet, u zhvillua ceremonia e përcjelljes për në banesën e fundit, të baba Hekuran Nikollarit. Kjo ceremoni u parapri nga dy dit' homazhesh për klerikun e ndjerë. Pas përshëndetjes së Kryegjyshit Botëror Bektashian, Dede Edmond Brahimaj, i cili përgatiti e drejtoi këtë ceremoni, folën gjithashtu dhe Ministrija e deputetja Mirela Kumbaro, Kryetarja e Bashkisë Përmet, Alma Hoxha; Kryetari i Bashkisë



Dede Edmond Brahimaj, duke bërë ritet e ceremonisë



Këlcyrë, Klement Ndoni; Qerim Zenuni, familjari i të ndjerit.

KRYEGJYSHI, DEDE EDMOND BRAHIMAJ

Në emër të Zotit mëshiruesit, mëshirëbërësit! Të nderuar vëllezër të mijë baballarë, dervishë, myhib, dashamirës të bektashizmit, besimtarë të teqesë Alipostivan, Frashër, gjithë krahinës së Përmetit, besimtarë të ardhur nga e gjithë Shqipëria dhe jashtë saj,

shumë të dashur myhib, miq, të afërm, bij e bija shpirtërorë të baba Hekuran Nikollarit. Të nderuar pjesëmarrës, përfaqësues të institucioneve qendrore e vendore, në këtë ceremoni mortore, në nder të baba Hekuran Nikollari! Ju falënderoj në emër të Kryegjyshit Botërore Bektashianë për nderimet që po i bëni në këtë ditë të trishtë për të gjithë, në humbjen e një kleriku të thjeshtë në dukje dhe jetesë, por shumë të përkushtuar, për

besimtarët, njerëzit në nevojë, bektashizmin dhe që jetën e tij ja dedikoi kësaj rruge të shenjtë e të vështirë!

Kryegjyshata Botërore Bektashianë dhe gjithë besimtarët bektashinj, janë në Zi prej mbrëmjes së datës 3 shkurt kur baba Hekuran kaloi nga kjo jetë! Hidhërim, dhimbje e boshllëk la ky largim i papritur për të gjithë ne. Por vepra e tij, kjo teqe, këta besimtarë do të mbajnë përjetë jehonën e dashamirësisë, respektit, mikpritjes, devotshmërisë, atdhedashurisë e ngrohtësisë shpirtërore. Teqe e Alipostivanit, teqe e Frashërit, u ringritën nga rrënojat e komunizmit nga puna e palodhur dhe me përkushtim e Babait aq shumë të dashur jo vetëm në këtë trevë por mbarë Shqipërinë. Sot, bektashizmi humbi një njeri të çmuar, një klerik të zellshëm e punëtor, me ndjenjë të thellë patriotizmi e përkushtimi.

Baba Hekuran Nikollari, u lind më 7 shtator 1963, në Seniçan të Përmetit. U rrit përmes halleve, por me dashurinë e madhe të prindërve, të cilët i dhanë ndershmërinë, mirësinë, arsimin, urtësinë dhe dashurinë për Shqipërinë. Në vitin 2000 u rikthye në atdhe pas emigrimit. E ktheu ndërgjegjja kombëtare dhe idetë atdhetare e bektashianë të Dede Reshat Bardhit dhe të Baba Aliut, të Alipostivanit. Në Seniçan rindërtoi Mekamin, në vendin e quajtur "Ahuri i Nakove", i cili sot quhet "I miri i Nakove". Më 22 mars 2001, ai shkoi në Alipostivan. Teqja ishte e shkatërruar në vitin 1967. Më 04 prill 2002, pasi qëndroi pak kohë, pranë Selisë së Shenjtë

VIJON NË FAQEN 6 >>

<< VIJON NGA FAQJA 5

në Tiranë, Haxhi Dede Reshat Bardhi, i veshi rrobën e bektashiut dhe u emërua dervish, në teqenë e Ali Horasanit të Alipostivanit, në Përmet. Në vitet 2007-2009, baba Hekurani emërohet dhe shërben si dervish në teqenë e Frashërit, të cilën e ringriti, duke ruajtur origjinalitetin e monumentit të historisë dhe kulturës të kësaj teqeje të famshme, e cila sot është një mrekulli e vërtetë. Disa vite, baba Hekurani, shërbeu në teqenë e Kulmakut Tomorr. Hekuran Fejzo Nikollari, i cili me Dekretin e Shenjtë Nr. 7 datë 29.12.2009 të Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, shenjtorit Haxhi Dede Reshat Bardhit, iu dha titulli ‘Baba’ dhe u emërua baba i teqesë së “Baba Nasibiut” të Frashërit, të teqesë së “Baba Aliut” në Alipostivan dhe të teqesë së “Baba Xhaferit” në qytetin e Përmetit.

Baba Hekurani i teqesë së Frashërit, Alipostivanit dhe Përmetit çdo ceremoni e mbyllte me fjalët “Rroftë Shqipëria”! Baba Hekurani është vlerësuar me titullin “Qytetar Nderi” nga Këshilli i Bashkisë së Skraparit; Titulli “Nderi i Frashërit”, nga Këshilli i Komunës së Frashërit, (Vendimi Nr. 19 datë 21.03.2015) dhe nga Presidenti i Republikës, me “Urdhrin Naim Frashëri i Artë”. Me punën e tij të palodhur drejtoi më së miri teqenë e Alipostivanit, Frashërit dhe bëri përpjekje të mëdha për ndërtimin e teqesë së baba Xhaferit në Përmet. Me autoritetin e tij dhe klerikut të devotshëm ka fituar admirimin respektin dhe dashurinë e gjithë besimtarëve dhe dashamirësve të Përmetit e më gjerë. Ai ka bërë identifikimin e të gjitha teqeve,



Pamje nga ceremonia



tyrbeve dhe vendeve të mira në Përmet, ngriti nga themelet teqenë e Cfratit në Bual të Përmetit me një tyrbe të mrekullueshme. Puna e tij është një kontribut i veçantë për bektashizmin. Vëllai im Baba Hekuran! Në emrin tim, të Kryegjyshit Botëror Bektashian dhe miliona bektashinjve që ju shërbeve me aq përkushtim, mirënjohje dhe falënderime, që ju përkushtove

me zell të pashembullt ri ngritjes së Teqeve bektashiane, bektashizmit e besimtarëve, dhe ri ndez besimin në Zot në zemrat e mijërave besimtarëve bektashinj në kohën më të vështirë! Vepra e ri ngritjes së Teqeve bektashiane të Alipostivanit, Frashërit, Craftit, në Shqipëri do të mbeten të pavdekshme në zemrat e gjithë besimtarëve. Bektashizmi humbi fizikisht një figurë të rëndësishme



dhe me peshë, por rrënjosi në historinë e udhës së saj të shenjtë një klerik mistik e shumë të dashur për këdo! I përjetshëm kujtimi yt baba Hekuran dhe e pavdekshme vepra jote e shenjtë! Shpirti yt u prehtë në paqe! Zoti na bekoftë të gjithëve! Amin!

ALMA HOXHA, KRYETARJA E BASHKISË PËRMET

I nderuar Kryegjysh, Haxhi Dede Baba, Edmond Brahimaj. Të nderuar besimtarë. Me dhimbje dhe respekt jemi mbledhur sot për të përcjellë për në banesën e fundit Baba Hekuran Nikollarin, një prej personaliteteve më të dashura për të gjithë ne. Baba Hekurani ishte një njeri i përkushtuar ndaj besimit, mbrojtës i identitetit kombëtar dhe përhapës i harmonisë fetare. Ai nuk ishte vetëm një udhëheqës shpirtëror,



Klerikët gjatë ceremonisë



por një njeri i urtë, i mençur, i cili u bë një pikë referimi për të gjithë, duke frymëzuar harmoni, paqe dhe humanizëm. Me përkushtimin e tij të palodhur, ai ndërtoi Teqenë e Alipostivanit, duke e kthyer atë në një qendër shpirtërore dhe një vatër dashurie për komunitetin. Po ashtu, ai dha një kontribut të jashtëzakonshëm në ri ngritjen e Teqesë së Frashërit, një monument me vlera të mëdha kulturore dhe historike, emri i të cilës nuk lidhet vetëm me Bektashizmin por me momentet më kyçe të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, me Rilindjen Kombëtare, me

Lidhjen Shqiptare të Prizrenit e mbi të gjitha me përpjekjet dhe kontributin e saj për gjuhën e shkollën shqipe. Falë punës së baba Hekuranit, kjo vatër e rëndësishme shpirtërore do të mbesë një simbol i historisë, besimit dhe identitetit tonë kombëtar.

...Sot, ndërsa i japim lamtumirën, drita e tij do të vazhdojë të ndriçojë këtë vend dhe zemrat e të gjithë atyre që e njohën dhe e deshën. Në emër të Bashkisë dhe qytetarëve, shpreh

VIJON NË FAQEN 8 >>

<< VIJON NGA FAQJA 7

ngushëllimet më të sinqerta për familjen, besimtarët dhe të gjithë ata që e nderuan...

KLEMENT NDONI, KRYETARI I BASHKISË KËLCYRË

...Që në konsakrimin e tij si baba, ai u vu në provën e vështirë dhe munduese jo vetëm të ringritjes dhe rimëkëmbjes së teqeve të rrënuara të zonës sonë, duke ruajtur origjinalitetin dhe vlerat e tyre historiko-kulturore, por edhe te ringjalljes së besimit në Zot, besim që ishte dëmtuar përdhunshëm prej ateizmit të kohës. Me mençurinë dhe urtësinë karakteristike të tij, baba Hekurani diti të përcjellë tek ne mesazhet më të pastra të besimit dhe orientimit mistik, i vetëdijshëm për të ardhmen tonë. Ai tregoi devotshmërinë karakteristike, të trashëguar ndër shekuj prej baballarëve dhe dervishëve bektashianë më të dëgjuar, si dhe në mënyrë të veçantë u frymëzua nga idetë atdhetare e bektashiane të Kryegjyshit Botëror Dede Reshat Bardhit dhe me bekimin e tij punoi pa u lodhur kudo që e kërkoi detyra ndaj Zotit. Baba Hekurani, gjatë jetës së tij në shërbim të Zotit nuk predikoi dhe përcolli tek besimtarët bektashianë vetëm fjalën e Zotit për paqen, harmoninë, mirëkuptimin, mirësinë, përkushtimin ndaj besimtarëve, por edhe si mbrojtës i identitetit kombëtar dhe përhapjes së harmonisë ndërfetare. ...E gjithmonshme dhe e gjithë kohëshme do të mbetet veprimtaria e tij shpirtërore, shoqërore dhe kombëtare, e cila përbën vlerën e madhe kulturore në shërbim të kombit dhe të gjithë



Pamje nga ceremonia



shqiptarëve. ...Ai do të mbetet në kujtesën tonë kombëtare si një klerik i palodhur, i devotshëm ndaj Zotit, i cili zgjodhi ti shërbente sa më mire komunitetit dhe vendit të tij. Të përjetshme do të jenë kujtimi dhe vepra e tij...

MIRELA KUMBARO, DEPUTETE

Duke ngushëlluar Kryegjyshin Botëror Bektashian, Haxhi Dede Edmond Brahimaj për humbjen e baba Hekuranit, ndër të tjera, deputetja Mirela Kumbaro tha: "...Baba Hekurani ishte një humanist, ishte një klerik e njeri, që na bekoi e uroi për më mirë në jetën dhe punën tonë. Ky objekt,

me përkujdesjen e ti, u realizua siç e shikojmë, dhe do të ngelet si një tempull në historinë e kulturës shqiptare... Baba Hekurani ishte klerik e njeri që përpigje të përcillte tek njerëzit besimin në Zot, në forcimin e përpjekjeve e dashurisë për atdheun. Ai nuk është sot mes nesh, por ka lënë punën dhe kujtimet e mira tek gjithë besimtarët e trevës e shumë më gjerë. Ngushëllim e dhe një herë Dede Mondin, për humbjen e baba Hekuranit. Faleminderit dhe për ju Kryegjysh, që na flet e bekon sot, që na bën pjesë me zemër, dhembshuri e dashamirësi, në këtë ceremoni, të përcjelljes së baba Hekuranit!"

JETËSHKRIM I BABA HEKURAN NIKOLLARIT

Baba Hekuran Nikollari, u lind më 7 shtator 1963, në Seniçan të Përmetit. U rrit përmes halleve, por me dashurinë e madhe të prindërve, të cilët i dhanë ndershmërinë, mirësinë, arsimin, urtësinë dhe dashurinë për Shqipërinë. Fejzua, babai i tij, u nda nga jeta më 1985, ndërsa e ëma, Vezirja, u nda nga jeta në vitin 2010. Baba Hekurani kreu shkollën fillore dhe shkollën 8-vjeçare “Riza Velçishti” në Seniçan. Më tej filloi shkollën e mesme “Kamber Bënja” në Bënje, por pas 2 vitesh, i detyruar nga vështirësitë ekonomike të familjes, e ndërpreu dhe filloi punën në kooperativën e Mërtinjit. Në vijimësi ka punuar në Ndërmarrjen e Bonifikimit në Përmetit, në Ndërmarrjen e Ujërave Këlcyre dhe në Shfrytëzim-Përpunimin e Drurit të Përmetit. Në vitin 1992, emigroi në Greqi, ku punoi në punë të ndryshme në Trikala, në Athinë, në Lamia, në ishullin Kolkidha dhe në Larisa. Në vitin 2000 u kthye në atdhe, në Seniçan. E ktheu ndërgjegjja kombëtare dhe idetë atdhetare e bektashiane të Dede Reshat Bardhit dhe të Baba Aliut, të Alipostivanit. Në Seniçan rindërtoi Mekamin, në vendin e quajtur “Ahuri i Nakove”, i cili sot quhet “I miri i Nakove”. Më 22 mars 2001, ai shkoi në Alipostivan. Teqja ishte e shkatërruar në vitin 1967. U mbështet tek familja e Refat Hasimit, familje me tradita atdhetare. Me Refatin, me

Demir Elmazin dhe besimtarët e Alipostivanit, ngritën në fillim tyrben e Baba Ali Horasanit. Për këtë pati bekimin dhe mbështetjen e Kryegjyshit Botëror Haxhi Dede Reshat Bardhi. Më 04 prill 2002, pasi qëndroi pak kohë, pranë Selisë së Shenjtë në Tiranë, Haxhi Dede Reshat Bardhi, i veshi rrobën e bektashiut dhe u emërua dervish, në teqenë e Ali Horasanit të Alipostivanit, në Përmet. Në vitet 2007-2009, baba Hekurani emërohet dhe punon si dervish në teqenë e Frashërit, të cilën e ringriti, duke ruajtur origjinalitetin e monumentit të historisë dhe kulturës të kësaj teqeje të famshme, e cila sot është një mrekulli e vërtetë. Disa vite, baba Hekurani, bëri shërbime në teqenë e Kulmakut Tomorr. Hekuran Fejzo Nikollari,

i cili me Dekretin e Shenjtë Nr. 7 datë 29.12.2009 të Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, shenjtorit Haxhi Dede Reshat Bardhit, iu dha titulli ‘Baba’ dhe u emërua baba i teqesë së “Baba Nasibiut” të Frashërit, të teqesë së “Baba Aliut” në Alipostivan dhe të teqesë së “Baba Xhaferit” në qytetin e Përmetit. Baba Hekurani i teqesë së Frashërit, Alipostivanit dhe Përmetit çdo ceremoni e mbyllte me fjalët “Rroftë Shqipëria!” Baba Hekurani është vlerësuar me titullin “Qytetar Nderi” nga Këshilli i Bashkisë së Skraparit; Titulli “Nderi i Frashërit”, nga Këshilli i Komunës së Frashërit, (Vendimi Nr. 19 datë 21.03.2015) dhe nga Presidenti i Republikës, me “Urdhrin Naim Frashëri i Artë”. Me punën e tij të palodhur drejtoi më së miri teqenë e

Alipostivanit, Frashërit dhe bëri përpjekje të mëdha për ndërtimin e teqesë së baba Xhaferit në Përmet. Me autoritetin e tij dhe klerikut të devotshëm ka fituar admirimin respektin dhe dashurinë e gjithë besimtarëve dhe dashamirësve të Përmetit e më gjerë. Ai ka bërë identifikimin e të gjitha teqeve, tyrbeve dhe vendeve të mira në Përmet, ngriti nga themelet teqenë e Cfratit në Bual të Përmetit me një tyrbe të mrekullueshme. Puna e tij është një kontribut i veçantë për bektashizmin. I paharruar qoftë kujtimi i tij!



14-17 JANAR, PËRVJETORI I 104 I MBAJTJES SË KONGRESIT TË PARË BEKTASHIAN

Nuri ÇUNI

Periodha 14-17 janar e këtij viti, ishte një ngjarje e shënuar përkujtimore, për besimtarët bektashian në Shqipëri dhe në botë, pasi plot 104 vjet më parë, në teqenë e njohur të Prishtës në Skrapar, u mbajt Kongresi i Parë Bektashian, që njihet si ‘Kongresi i Prishtës’. Ky kongres, mori vendime tejet të rëndësishme. Kjo ngjarje përkujtohet në të gjitha institucionet bektashiane.

“...Kongresi i Parë Bektashian i Prishtës, është një ngjarje me rëndësi në historinë e bektashizmit. Vendimet e këtij Kongresi, krijuan një bazë të fuqishme për shtrirjen e këtij besimi të paqtë, funksionimin organizativ të tij dhe rritjen e rolit të klerikëve si predikues shpirtëror tek besimtarët, rritjen e besimit në Zot dhe forcimin e ndjenjës atdhetare. Duke përkujtuar sot këtë ngjarje të shënuar, ne kujtojmë dhe kontributin e shquar të klerikëve bektashian, që si fetarë e atdhetarë, me këtë kongres, shënuan një pikënisje më të fuqishme për besimin tonë të paqtë dhe aspiratat kombëtare”- pohon mes të tjerash, Haxhi Dede Baba, Edmond Brahimaj, Kryegjysh Botëror i Bektashizmit.

Historia e teqesë dhe pozicioni i saj, ishin ndër faktorët kryesor që për Kongresin e Parë Bektashian, u zgjodh Prishtë. Historia e teqesë së Prishtës lidhet dhe me kohën pas themelimit të teqesë së Frashërit. Të dhënat burimore flasin se në vitin 1781 u ngrit teqeja e Frashërit, të cilën e



Dede Edmond Brahimaj me Nuri Çunin, Zalo Qaton e besimtarë të tjerë, në teqenë e Prishtës.

drejtoi baba Nasibi Tahiri. Me fjalët e çuditshëm ai ka thënë: “Me emrin Tahir kam ardhur më parë në Malind të Skraparit, tani këtu, në Frashër e si të vdes këtu, kam për të vajtur në Prishtë ku do të bëj gjithë këto vepra mirëbërëse”.

Teqenë e Pishtës e themloi baba

Tahir Prishtë (Kotobelli), në vitin 1815. ...Baba Tahiri, në këtë mision, u përkrah nga besimtarët e tij dhe nga mytesarifi i Beratit, Hysen Virioni. Së pari, ai e forcoi ekonomisht teqenë dhe krijoi një bibliotekë të pasur me libra. Ai punoi me përkushtim në përhapjen e bektashizmit dhe ngriti

KLERIKË QË KANË SHËRBYER NË TEQENË E PRISHTËS



Klerikët në teqenë e Prishtës



Baba Shaban Prishtë



Dervish Veli Veli Prishtë



Dervish Ismail Prishtë



Dervish Ismail Prishtë



Dervish Ismail Prishtë



Dervish Ismail Prishtë



gjithë popullin në zonat e Oparit, Tomoricës, Skraparit, Dëshnicës (krahina e Këlcyrës së Përmetit), Toskërisë së Tepelenës (nga fshatrat Arrëza, Maricani, Shalësi, Buzi, Gllava e deri në Klos dhe Hekal zëmrën e Mallakastrës së sipërme) dhe Nahijes së Beratit (Nga Bargullasi, Novanji, Kapinova, Peshtani, Roshniku, Karkanjozi, Tozhari, Çorrogjafi, Zhabokika, Plashniku, Melishti) deri në Luar, Kurjan, Lapulec dhe Cakrajn, në kërthizën e Mallakastrës së poshtme. ...Pasuesit e tjerë në drejtimin e teqesë së Prishtës njihen: baba Xhaferi, baba Ahmeti, baba Shabani, baba Hysen Panariti, të cilët kontribuan në përhapjen e gjuhës shqipe. Baba Xhaferi më 1908 ngriti shkollën e parë shqipe në Çorovodë dhe ndikoi me patriotët e tjerë në arsimin e Skraparit. Teqeja u bë qendër e rëndësishme në rilindjen kombëtare. Baba Shabani me patriotët

e tjerë, Hasan Koprëncka, Mahmud Zaloshnja, Jaçe Gjergjova, Fetah Sevrani, Zenjel Braçi morën pjesë në mbrojtjen e shkronjave shqipe. Baba Hyseni e Baba Kamberi, i ardhur nga Amerika, ndihmuan në përgatitjen e kongresit bektashian të vitit 1921. Teqeja kishte pasuri të madhe dhe një bibliotekë të pasur me libra. Ajo u dogj nga andartët grekë në vitin 1914. Në gazetën "Liria e Shqipërisë" në datën 27 mars 1915, Varf Aliu, dervish i kësaj teqeje, shkruan: "Prishta është një nga fshatrat e malësisë së Skraparit, ku 60 vjet e po tehu gjendet Shtëpi Zoti (teqe) pan-bektashiane, në të cilën gjer njëditëzaj jetonin afro 30 veta varfë. Këtë shtëpi të madhe hijerore që po rrëfej e ka djegur njëherë më parë qeveria turke dhe prapë u ndërtua, por mjerisht vandalët e Kostësi, duke parë që kjo Shtëpi Zoti epte dritën e zgjimit të populli i paditur shqiptar, si në të gjithë fshatrat dhe

në Prishtë, u derdhë me egërsi: vranë, prenë, plaçkitën teqenë edhe shtëpitë e fshatit dhe ikën praptazi, ku morën tok varfë e fshatarë si robër." Teqeja u ringrit në vitin 1920. Teqeja ishte e ndërtuar me mur guri me rreshta të rregullt. Ajo ishte e përbërë nga dy blloqe katrorë me dy kate dhe një qendrorë me një kat të vetëm, në gurë të veçantë kish simbole bektashiane. Teqenë e ka vizituar dhe studiuesi J. Swire. Më 1967-ën, ajo u mbyll. Ajo u kthye në magazinë, më vonë në stalla të bagëtive dhe, në vitet 1985, u shkatërrua plotësisht. U rihap në vitin 2004, me një tyrbe të baba Tahirit. Më pas nën kujdesin e gjyshit të Skraparit u ringrit teqe e re, jo si e para tradicionale. Në gusht të vitit 2020 u vendos busti prej bronzi i Dede Kamberit në mirënjohje të këtij kleriku të shquar...

MASAT PËRGATITORE

Historiku i ngjarjeve në vendin tonë, në fillim të vitit 1920, pas Kongresit të Lushnjës në Shqipëri u krijua një situatë e favorshme për riorganizimin e bektashinjve të Shqipërisë. Kongresi i Lushnjës në janar të vitit 1920 i jepte liri fesë. Në Nenin 93 të Statutit të këtij Kongresi merreshin në mbrojtje besimet fetare. Nga korriku deri në dhjetor të vitit 1920 baballarët bektashinj u morën për përgatitjen e Kongresit bektashian. Ahmet Turani dhe baba Hysen Prishta, të mbështetur edhe nga intelektualët shqiptarë, i paraqitën qeverisë së re demokratike në datë 13.07.1920 një program ku kërkohej leja për thirrjen e një kongresi bektashian me motivacion "për një reformë bektashiane morale, siç citohej nga Kryeministria në shkresën e datës 23.12.1920". Në program sqaroheshin data kur do të mbledheshin baballarët (14 janar 1921), vendi ku do të mbledhej teqe e Prishtës realizimi i kongresit vetëm nëse merrte pjesë edhe përfaqësuesi i shtetit. Përgatitjet për të mbledhur një kongres bektashian u bënë "intensive" gjatë muajve të fundvitit 1920. Zyrtarisht, organizatorët i



Busti i Dede Kamberit në teqenë e Prishtës

VIJON NË FAQEN 12 >>

dërguan kërkesë (firmosur nga baba Ahmet Turhani i Tepelenës dhe baba Hyseni i teqesë së Prishtës), qeverisë së Sulejman Delvinës që në Kongres të merrte pjesë dhe përfaqësues i qeverisë, i cili ishte bektashi. Babai i shquar i teqesë Turanit Tepelenë, baba Ahmet Turani dhe baba Hysen Prishta, përgatitën strukturën e plotë për këtë Kongres të rëndësishëm dhe në komunikimin me shtetin shqiptar, morën të gjitha masat organizative për organizimin e Kongresit. Në këtë kuadër, për të ardhur tek kjo ditë, njihet interesimi i jashtzakonshëm i intelektualëve shqiptarë të asaj kohe si Ferid Vokopola, Jashar Erebara, Mithat Frashëri dhe të tjera figura të këtij kalibri, të cilët u interesuan për zhvillimin e bashkësisë bektashiane. Kurse Aqif Pashë Elbasani, figurë e njohur, personalitet bektashian, i drejtohet Kryeministrit me shkresë: “Kabineti i parë u pat dhënë leje baballarëve që ta bëjnë atë mbledhje dhe janë lajmëruar Prefektura e Beratit dhe e Gjirokastrës mbi këtë gjë... Prej nisëtorve të kësaj mbledhjeje, baba Ahmet Turhanit e baba Hysen Prishta, na kërkohet edhe një delegatë nga ana e Qeverisë, i cili do të gjendet gati në atë mbledhje. Ata dëshirojnë që të çohet nga ana e Qeverisë si delegatë Kadri Vesel Efendiu ose Halim Bej Gostivari. Më gjithë këtë, ata shtojnë se Qeveria mund me çue cilin të dojë, vetëm duen që delegati i Qeverisë të jetë edhe ai Bektashi”. (Shkresa mban datën 28/ XII/1920)

ÇFARË VENDIMESH U MORËN

Kongresi mori vendime të rëndësishme, duke filluar që nga Statuti. Statutin bektashian, që u quajt “Lidhja bektashiane” kishte 28 nene. U zgjodh për herë të parë Këshilli Atnor për drejtimin dhe organizimin e bektashizmit në Shqipëri me qendër në teqenë e Sukës, Përmet, me kryetar baba Ahmet Turanin. Këshilli Atnor përbëhej nga 7 anëtarë. Në nenin 1 të tij thuhet: “Për administrimin fetar të teqeve bektashi të Shqipërisë e për



Kryegjyshi Botëror, Dede Baba, Edmond Brahimaj dhe Zalo Qato, sekretar i Gjyshitës, Skrapar.

të mbajtur rregullin e grupit klerikal bektashian, Kongresi i Prishtës i dha fuqi kryesimi ‘Këshillës Atnore’, që u formua prej Gjysh Ahmet Baba Turani”. Këshilli Atnor përbëhej nga 7 anëtarë: nga gjysh Ahmet baba Turhani, gjysh Sulejman baba Gjirokastra, Ahmet baba Elbasani, Xhemal baba Përmeti, Mustafa baba Frashëri, Kamber baba Prishta, Hajdar baba Turani. Për herë të parë u krijua arka e përgjithshme e bektashinjve si dhe themelimi i Mësimores Bektashiane në teqenë e Sukës. Ky këshill kishte kompetenca të plota për administrimin e teqeve në Shqipëri. Kongresi i Parë bektashian, ka rëndësi historike, se është i pari në Shqipëri, që formoi Komunitetin Bektashian Shqiptar. Në Kongresin Bektashian në Prishtë u caktua statusi i këtij komuniteti, vërtetimi i të cilit prej Këshillit Ministror, do të bënte të mundur të zbatoheshin ligjërisht de facto vendimet e marra në këtë kongres. Me këtë status Tarikati bektashian shpallej “Komuniteti i Pavarur”. Statuti i hartuar në këtë Kongres të Parë të Bektashianëve shqiptarë luajti një rolë të veçantë për zhvillimin e bashkësisë bektashiane në trevat e Shqipërisë. Në këtë status synohej çelja e shkollave për klerikët e këtij tarikati, përkthimi i literaturës bazë bektashiane etj.

TRASHËGIMI E VYER

Kongresi i Parë bektashian i Prishtës i janarit 1921, mbetet një trashëgimi i vyer për kombin shqiptar përbën një nga vlerat më të spikatura të bektashizmit dhe kontributeve që ka dhënë. Për bektashianët shqiptarë si në Rilindjen kombëtare dhe gjatë gjithë historisë së popullit tonë me devizën “Pa atdhe nuk ka fe”, mbi gjithçka ishte atdheu. Ata e zbatuan me dëlirësi porosinë e krye-bektashiut Naim Frshëri, i cili theksonte baballarët duhet të kryesojnë me fjalë të shenjta luftën për liri. Varfët (dervishët) të bëhen shokë në gëzime dhe hidhërimë. Myhibët, antarë spiritual bektashian të mos kursehen nga vdekja për atdhe. Gjithsesi, Statuti i parë i bektashinjve shqiptarë, lozi një rol të veçantë jo vetëm për zhvillimin e besimit bektashian në Shqipëri dhe më gjerë, por ishte edhe një model i shkëlqyer për hartimin e statuteve të tjera për komunitetet fetare të cilat shërbenin për unifikim kombëtar. Rëndësia historike e Kongresit, i cili u mbajt në Prishtë, ishte e madhe, e jashtëzakonshme për bektashizmin. Për herë të parë u krijua Komuniteti Bektashian Shqiptar. Në këtë mënyrë u krijua institucioni i parë dhe i organizuar pas kaq shekujve për ardhmërinë e besimit bektashian.

AMBASADORJA E OKB-SË NË SHQIPËRI, ZNJ. FIONA MCCLUNEY, VIZITON SELINË E SHENJTË BEKTASHIANE NË TIRANË



Kryegjyshi Botëror, Dede Edmond Brahimaj, me Ambasadoren e OKB-s në Shqipëri, znj. Fiona McCluney

Më 3 shkurt 2025, në Selinë e Shenjtë, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede

Baba, Edmond Brahimaj priti në një takim, Ambasadoren e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, znj. Fiona McCluney.

Gjatë bisedës, u diskutua mbi angazhimin dhe përfaqësimin e Kryegjyshit në institucionet evropiane dhe bashkëpunimin me strukturat e OKB-së.

Një nga pikat kryesore të takimit ishte prezantimi i dy projekteve të rëndësishme që synojnë promovimin e turizmit ndërfetar

dhe pasurive të bektashizmit, duke theksuar vlerën e harmonisë fetare në Shqipëri si një model i rrallë bashkëjetese.

Ambasadorja McCluney pati gjithashtu mundësinë të vizitonte muzeun e Kryegjyshit, duke u njohur nga afër me historinë, kulturën dhe trashëgiminë e pasur bektashiane, si dhe me pasuritë shpirtërore dhe kulturore që Shqipëria mbart.

Ky takim përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e dialogut ndërfetar dhe bashkëpunimit institucional për promovimin e paqes dhe tolerancës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.



Pritja e delegacionit të Holandës në Selinë e Shenjtë Bektashiane

NJË DELEGACIONI HOLANDEZ, VIZITON KRYEGJYSHATËN BOTËRORE BEKTASHIANE

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Baba Edmond Brahimaj priti më 14 janar 2025, në Selinë e Shenjtë të Kryegjyshit Botëror Bektashian, delegacionin e Shtetit të Holandës, të kryesuar nga znj. Bea-Sen Tussher, e dërguar speciale e Ministrisë së Jashtme të vendeve të ulëta për fetë dhe liritë fetare.

Pas përshëndetjeve të rastit, Kryegjyshi Botëror e njohu delegacionin me rolin historik që ka luajtur Bektashizmi në çështjen kombëtare. Ai theksoi se vizioni që përçon Bektashizmi sot është një mesazh i madh për harmoni, tolerancë dhe bashkëjetesë fetare, si thesari i unitetit, sigurisë dhe paqes.

Gjithashtu Kryegjyshi Botëror shtoi se nisma e Kryeministrit të Shqipërisë, z. Edi Rama, për krijimin e shtetit sovran bektashi,



Dede Edmond Brahimaj Zj. Bea-Sen Tussher

është një vlerësim për rolin që ka luajtur Kryegjyshata Botërore si qendër e bektashinjve në mbi 33 vende të botës dhe për vizionin e bektashizmit për paqe dhe vëllazëri botërore, me të gjitha fetë dhe të gjithë popujt, për të ecur së bashku dhe për të jetuar si vëllezër. Znj. Bea-Sen Tussher, pasi falënderoi Kryegjyshin

për mikpritjen, theksoi se roli i bektashizmit është shumë i rëndësishëm për promovimin e vlerave të islamit të sotëm, të integruara në shoqërinë e sotme europiane. Ajo vlerësoi gjithashtu se shteti Sovran Bektashi do të përçojë vlera të reja, të domosdoshme për shoqërinë e sotme njerëzore.



Dede Edmond Brahimaj, me ish-Kryepiskopin Anastas Janullatos

NDËRRON JETË, FORT LUMTURIA, KRYEPESHKOPI ANASTAS JANULLATOS. KRYEGJYSHI BOTËROR BEKTASHIAN, DEDE EDMOND BRAHIMAJ: LAMTUMIRË VËLLAI IM!

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Baba, Edmond Brahimaj, nëpërmjet një mesazhi, shprehu ngushëllimet më të sinqerta, për kalimin nga jeta të Kryepeshkopit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlumturisë së Tij, Anastas Janullatos, më 25 janar 2025.

Në mesazhin e Tij, ndër të tjera, Kryegjyshi Botëror, Dede Edmond Brahimaj shkruan: *“Bismilahi Rramani Rrahim! Në emër të Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Me hidhërim të thellë, mora lajmin e hidhur, të kalimit nga kjo jetë e përkohshme, e vëllait tonë, Fortlumturisë së Tij, Kryepeshkopit të Tiranës, Durrësit dhe Gjithë Shqipërisë, Anastas Janullatos. Fortlumturia e Tij, Kryepeshkopi Anastas, në kushte të vështirësive të mëdha, për më shumë se 30 vite, ringriti Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe kontribuoi në harmoninë e bashkëjetesës fetare në Shqipëri. Në emër të Selisë së Shenjtë të Kryegjyshit të Botërore Bektashiane, më lejoni të shpreh konsideratën më të lartë, për veprimtarinë e tij gjatë gjithë jetës dhe si për bashkëpunimin e ngushtë me të, për bashkëjetesën fetare në Shqipëri dhe më gjërë. Ju siguroj se kujtimi i Tij, do të jetë kudoherë një burim mirësie, për miliona besimtarë ortodoksë, të kudondodhur në botë. Ngushëllimet më të ndjera për këtë humbje të madhe e të pazëvendësueshme për drejtuesit e lartë të Kishës dhe mbarë komunitetin ortodoks të Shqipërisë! Të*



Dede Edmond Brahimaj, duke bërë homazhe

prehet në paqen e merituar! Amin!”

Gjithashtu, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Baba, Edmond Brahimaj mori pjesë në homazhet në nder të Kryepeshkopit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlumturisë së Tij, Anastas Janullatos. Në këto homazhe morën pjesë edhe shumë besimtarë ortodoksë, përfaqësues të politikës e të institucioneve shtetërore e fetare dhe qytetarë e dashamirës të shumtë, duke vendosur kurora me lule e përcjellë ngushëllimet e tyre për ndarjen nga jeta të Fortlumturisë së Tij, Anastas Janullatos.

Kryegjyshi Botëror Bektashian, pasi i shprehu ngushëllimet më të sinqerta, Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, dhe gjithë besimtarëve ortodoksë, për këtë humbje, la dhe shënimin e Tij në librin e ngushëllimeve.



Dede Edmond Brahimaj, mes pjesëmarrësve në aktivitet

PËRKUJTOHET NË GJAKOVË, 4-VJETORI I KALIMIT NGA JETA, I BABA MUMIN LAMA

Ditën e hënë, 27 janar 2025, në teqenë e Gjakovës-Kosovë, u përkujtua 4-vjetori i kalimit nga jeta, i baba Mumin Lama, ish-Kryetar i Gjyshitës Bektashiane të Kosovës.

Në këtë aktivitet, mori pjesë dhe Kryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Baba, Edmond Brahimaj. Dede Edmond Brahimaj, që drejtoi edhe ritet e këtij përkujtimi.

Ikja nga kjo jetë e klerikut Mumin Lama, do të përkujtohet në këtë ditë dhe në gjyshatat e tjera bektashiane, brenda dhe jashtë Shqipërisë. “...Vëllai jonë, baba Mumin Lama, përvjetorin e katërt të ikjes nga jeta që ne po e përkujtojmë sot, ka dhënë një kontribut të rëndësishëm fetar e atdhetar për

bektashizmin, në Gjakovë e Kosovë. Veçanërisht, ai pati një rol të rëndësishëm, para dhe gjatë luftës së Kosovës, kohë në të cilën pushtuesit serbë, nuk kursyen dhe objektet bektashiane, duke e djegur dhe teqenë e Gjakovës, një objekt i rëndësishëm fetar e atdhetar...” - pohoi mes të tjerave Kryegjyshi Botëror, Dede Baba, Edmond Brahimaj.

* * *

Baba Mumin Lama lindi më 1 qershor të vitit 1949 në Gjakovë, nga një familje e njohur e besimit bektashian. Në vitin 1987, ai pranohet myhib i baba Tajarit. Meqë shfaqti vlera të larta morale, kombëtare e fetare, në vitin 1993, babai Tajari, e gradoi Mumin Lamën ‘Dervish’. Pas kalimit nga jeta i baba Tajarit



Baba Mumin Lama

më 1994, anëtarët e Teqesë së Gjakovës, vendosën që prijësi i zgjedhur të jetë dervish Mumin Lama. Në vitin 1996, bazuar në rregullat e Tarikatit Bektashian, Baba Mumin Lama u emërua postnishin i teqesë së Gjakovës nga Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Baba Reshat Bardhi. Baba Mumini, u vu në krye të teqesë së Gjakovës, në kohëra të vështira për Kosovën. Dekada e 90-të e shekullit të 20-të,

u veçua në histori për dhunën e gjithanshme të regjimit serb ndaj popullatës shqiptare; u mbyllën institucionet e shkollat. Por, baba Mumini, duke njohur traditën bektashiane dhe atë të vetë teqesë që drejtohte, u angazhua që këtë tempull fetar ta kthejë në qendër për manifestime fetare-kulturore-artistike e historike, e njëkohësisht e dha teqenë për shkollë, për maturantët e gjimnazit të Gjakovës.



Pamje nga aktiviteti



Baba Sherif Canometaj dhe Baba Ismail Jangulli

PËRKUJTOHEN, 31-VJETORI I KALIMIT NGA JETA, I BABA SHERIF CANOMETAJ DHE 7-VJETORI I KALIMIT NGA JETA TË BABA ISMAIL JANGULLIT

Të premten, më 14 shkurt 2025, bektashinjtë përkujtuan 31-vjetorin e kalimit nga jeta, të klerikut të njohur bektashian, baba Sherif Canometaj dhe 7-vjetorin e kalimit nga jeta të baba Ismail Jangullit. “...Më 14 shkurt të këtij viti, ne përkujtojmë 31-vjetorin e kalimit nga jeta, të baba Sherif Canometaj dhe 7-vjetorin e

kalimit nga jeta të Baba Ismail Jangullit, dy klerikëve të cilët kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për bektashizmin në Shqipëri dhe më gjerë. Kujtimi dhe vlerësimi i këtyre dy klerikëve, ashtu si dhe i klerikëve të tjerë që kanë lënë gjurmë në historinë tetëshekullore të besimit tonë të paqte bektashian, ka qenë dhe do të mbetet kurdoherë përparësi në praktikën e Selisë së Shenjtë... Ne i kemi mbajtur

në zemra gjatë gjithë kësaj kohe baba Sherifin dhe baba Ismailin, siç iu mbajmë emrat e shquar të qindra dervishëve dhe baballarëve të tjerë, të cilët, vunë në themelet e bektashizmit jo thjesht këmbënguljen dhe përkushtimin, por krejt jetën e tyre. Baba Sherifi dhe baba Ismail Jangulli ishin dhe mbeten modeli i klerikëve të përkushtuar...”- pohon mes të tjerave, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e



Dede Reshat Bardhi, Dede Edmond Brahimaj dhe baba Ismail Jangulli

Tij, Haxhi Dede Baba, Edmond Brahimaj.

...**Baba Sherif Canometaj** ka lindur në 4 gusht të vitit 1908 në fshatin Zhapokikë-Tepelenë, në një familje me tradita bektashiane. Mësimet e para i mori tek Sheh Beqir Toçi. Në moshën 11 vjeç lexonte lirshëm në shqip dhe arabisht. Shpesh vizitonte shpesh teqetë, në Koshtan, Turanë, Rabije, Memaliaj dhe ato të Gjirokastrës. Në moshën 27-vjeçare, në vitin 1935 mori dorë në teqenë e Koshtanit, nga baba Shefqet Koshtani, i cili e gradoi “Dervish”. Më 1943, vazhdoi kursin për dervish në Kryegjyshatë, por për arsye të Luftës u ndërpre. Kursin e rifilloi dhe e ndoqi në vitet 1945-1946. Baba Sherifi mësoi edhe me mësues privat me

Hafiz Ali Korçën, i cili qëndronte për çdo vit dy-tre muaj në teqenë e Madhe në Elbasan. Ai mësonte edhe gjuhë të huaja arabisht, turqisht, italisht e persisht, filozofi e letërsi. Ngjarjet e marsit të vitit 1947 në Kryegjyshatë, vrasja e



Baba Ismail Jangulli

baba Fajës dhe baba Fejzës dhe Kryegjyshi Abaz Hilmi Dede, e futën në burg për dy muaj. Më pas, më 4 nëntor të vitit 1948, u emërua nga Dede Ahmeti, baba në teqenë e Greshicës. Baba Sherifi ka lëvizur më pas në teqenë e Çorrrushit, Mallakastër, teqe e Zallit, në Kryegjyshatë, në teqenë e baba Xhemalit, Elbasan, në teqenë e Martaneshit dhe në vitin 1960-1964 në teqenë e Prishtës-Skrapar. Së fundi shërbeu në teqenë e Madhe Elbasan deri në vitin 1967, kohë në të cilën u ndalua feja. Pas kësaj u mor me tregti, ku shiti cigare për 23 vjet në Elbasan. Në periudhën, 1967-1990, ai mbajti gjallë besimin bektashian duke përdorur shtëpinë e vet si teqe...

Baba Sherifi ka shumë

VIJON NË FAQEN 20 >>



Kryegjyshi Botëror Bektashian, Dede Edmond Brahimaj, me baba Ismail Jangullin

<< VIJON NGA FAQJA 19

vlerësime nga populli i trevave të Tepelenës, Gjirokastrës, Skraparit, Martaneshit, Përmetit, Mallakastrës, Elbasanit, Korçës etj. Kaloi nga jeta më 14 shkurt 1994.

...Baba Ismail Jangullit, ka lindur në fshatin Godvi të Zerqanit, prefektura Dibër më datë 05.05.1932. Ai u lind dhe u rrit në një familje të madhe patriarkale me tradita patriotike. Ai u rrit me edukatën bektashiane që në fëmijëri. Nëna e tij, Hidja e kishin marrë dorën e besëlidhjes tek baba Zeneli në Bllacë, gjë që ndihmoi drejtpërsëdrejti në edukimin e këtij djaloshi. Baba Ismaili, në moshën 23-vjeçare, me datë 22/03/1954, merr besëlidhjen bektashiane tek baba Xhemal Selsa. Baba Ismaili, fillimet e veta i filloi si arsimtar, në shumë fshatra të Peshkopisë. Me vonë, punon në ndërmarrjen e furnizimit të punëtorëve në Thekër të

Martaneshit si magazinier, si kuzhinier dhe si shitës dyqani. Me vonë vjen në Bulqizë dhe punon po në këtë ndërmarrje në punishten e ëmbëlsirave. Në



Baba Ismaili, fillimet e veta i filloi si arsimtar, në shumë fshatra të Peshkopisë. Me vonë, punon në ndërmarrjen e furnizimit të punëtorëve në Thekër të Martaneshit si magazinier, si kuzhinier dhe si shitës dyqani. Me vonë vjen në Bulqizë dhe punon po në këtë ndërmarrje në punishten e ëmbëlsirave. Në vitin 1967 ku u prishën të gjithë kultet e besimeve të ndryshme në Shqipëri, Ismail Jangulli e përjeton shumë keq këtë katastrofë.

vitin 1967 ku u prishën të gjithë kultet e besimeve të ndryshme në Shqipëri, Ismail Jangulli e përjeton shumë keq këtë katastrofë.

Më 31/03/1976 arrestohet me akuzën “Agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor”, dhe dënohet me 10-vjet burg. Dënimin ai e kreu në Spaç të Mirditës ku nga 10 vite, bëri 5 vjet e 6 muaj. Në vitin 1981 lirohet nga burgu dhe kthehet pranë familjes së tij. Me ndërrimin e sistemeve, baba Ismail Jangulli merr në dorëzim teqenë e Bllacës dhe në gusht të vitit 1998, vishet dervish. Më 4 prillit 1999, baba Ismaili merr dekretin e Shenjtë të ‘Babait’ nga Haxhi Dede Reshat Bardhi, Kryegjyshi Botëror Bektashian. Baba Ismail Jangulli, i vlerësuar nga Presidenti i Republikës me Dekoratin “Nderi i Kombit”, ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, në ngritjen dhe lartësimin e emrit të mirë të kësaj Teqeje të njohur. Ndërroi jetë më 14.02.2018

PËRKUJTOHET 44-VJETORI I KALIMIT NGA JETA, I BABA QAZIM BAKALLIT



Baba Qazim Bakalli.

Më 15 shkurt 2025, në teqenë e Gjakovës, Kosovë, klerikë e besimtarë të shumtë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, nga Selia e Kryegjyshit Botërore Bektashianë dhe nga gjyshata e grupe besimtarësh bektashianë, nga vende të ndryshme evropiane e më gjërë, përkujtuan 44-vjetorin e kalimit nga jeta, të baba Qazim Bakallit, I njohur si klerik, atdhetar, eurodit, përhapës i gjuhës shqipe, duke lënë gjurmë të pashlyera. Në këtë ceremoni morën pjesë



Dede Edmond Brahimaj

gjithashtu edhe drejtues e përfaqësues të institucioneve vendore, përfaqësues të besimeve të tjerë fetare e dashamirës të shumtë. Ritet e kësaj dite u drejtuan nga Kryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Baba, Edmond Brahimaj.

Përhëndetja e Kryegjyshit Botëror, Dede Edmond Brahimaj.

Në emër të Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Të nderuar Klerikë bektashinj dhe

VIJON NË FAQEN 22 >>

<< VIJON NGA FAQJA 21

përfaqësues të Komuniteteve të tjera fetare në Kosovë! I nderuar vëllai im Dervish Rauf Radoniqi! Të nderuar dashamirës, pjesëmarrës të mirëseardhur të Gjyshitës Bektashiane Gjakovë! Ju falenderoj që keni ardhur sot, në këtë ditë të shënuar e të shenjtë për Bektashizmin në nderimin e 145-vjetorit të lindjes dhe 44-vjetorit të kalimit nga jeta së Baba Qazim Bakallit. Jemi të nderuar dhe krenarë që në këtë ditë të shenjtë ne përkujtojmë këtë figurë të çmuar dhe tepër të dashur për bektashizmin, këtë kontribues të denjë të udhës bektashiane që meriton të gjithë mirënjohjen tonë.


Baba Qazimi lindi në Gjakovë më 03.01.1880, nga një familje me tradita bektashiane. Pasi mbaroi shkollën fillore në gjuhën turke, në vitin 1909 vazhdoi shkollën normale të Shkupit. Tek baba Qazimi vihej re zgjuarsia; ai mësonte me pasion të gjitha lëndët mësimore. Gjatë kësaj periudhe shkollore si nxënës i shkëlqyer dhe aktivist i rinisë patriotike shqiptare “Shubani Vatan”, përjashtohet nga shkolla në vitin 1912. Më vonë, kreu edhe shkollën normale në Elbasan. Si mësues, në periudhën 1913-1914, punoi në Shijak. Më pas, u emërua sekretar, në komunën e Bytyçit dhe më vonë Krahinar në të njëjtën trevë. I rikthehet arsimit duke punuar si mësues, në Poliqan-Lumë, ku hapi dhe një shkollë të re, në fshatin Shtiqen. Në këtë kohë mbante lidhje me Bajram Currin. Për këtë u burgos në Krumë dhe pastaj e çuan në burgun e Shkodrës, ku qëndroi pesë muaj. Ai ishte anëtar i Degës së



Baba Qazim Bakalli

Komitetit Mbrojtja Kombëtare të Kosovës, në Gjakovë e rrethinat e saj. Në këtë periudhë, baba Qazimi i futet udhës fetare, në bektashizëm. U bë myhib nga Haxhi Adem Vexh-hi Babai. Mori njohurit e doktrinës bektashiane brenda një kohe të shkurtër në teqenë e baba Hamzës në Shtip. Uniformën e dervishit e veshi në Fushë Krujë, nga Haxhi Mehmet Babai. Rregullin e virgjërisë e bëri nga Sali Nijazi Dedei. Shërbeu dervish në Shkodër pranë baba Hajdar Stambollit, në vitin 1932 pastaj në Elbasan në teqenë e Xhefai Ibrahim Babait. Kryegjyshitin Salih

Niazi Dede Baba e aktivizoi në dhënie mësime në arabisht, turqisht, persisht, për përgatitjen e kuadrit të ri klerikal. Në vitet 1930-1931, baba Qazim Bakalli, ishte mësues i kursit të dervishëve në Kryegjyshit. Më vonë Dervish Qazim Bakalli, u dërgua në teqenë bektashiane të Tetovës, në Harabati Baba, sipas kërkesës të Kryetarit të Bashkisë së Tetovës, Dr. Xhafer Sulejmani, drejtuar Kryegjyshitës, për rihapjen e teqesë, Harabati Baba, e cila ishte pa klerikë. Më 6 tetor 1941, dervish Qazim Bakalli dhe dervish Musa u nisën nga teqeja e baba Xhemalit, Elbasan, sipas urdhrorit të Kryegjyshit Botëror të




Bektashinjtë, Sali Niazi Dede dhe shkuan në teqenë e 'Harabati Baba', në Tetovë. Këtu i mirëprititi, Kryetari i Bashkisë dr. Xhafer Sulejman, i cili i mbajti në shtëpinë e tij deri sa u rregullua vendi në teqe. Të dy dervishët u mirëpritën për zemërsisht nga popullsia e Tetovës e rrethinat, nga myhibët dhe dashamirësit e bektashizmit. Në kushte të vështira, dervish Qazimi dhe dervish Musa kaluan dimrin e viteve, 1941-1942. Kjo gjendje vazhdoi deri në prill të vitit 1942. Më pas, të dy dervishët u morën me riparimin e teqesë. Në këtë periudhë për nevojat e teqesë dhe problemin pronave, falë punës e përkushtimit, dervish Qazimi, merr gradën "Baba," nga Kryegjyshi i asaj kohe, Sali Niazi Dede dhe drejton teqenë 'Harabati Baba' në Tetovë. Me punën këmbëngulëse të baba Qazimit dhe dervish Musës, u riparua teqeja dhe në fillim të shtatorit 1944, u soll uji (me ujësjellës) nga burimi i pyllit të teqesë. Në vitet 1942-1944, në teqenë Harabati filloi një gjallëri fetare, kulturore, arsimore, ku dy klerikët u përkrahën nga gjithë besimtarët

bektashian, intelektualët e dashamirësit e Tetovës, Gostivarit, Kërçovës dhe më gjerë. Në vitet 1945-1946, represioni serb filloi edhe ndaj teqesë 'Harabati-Baba'. Baba Qazimi dhe dervish Musa vazhduan aktivitetin në Tetovë, por përsëri hasën në vështirësi, sa që i burgosën me qëllim që t'i ekzekutojnë.. Ai ripërtëriti jetën fetare dhe

kulturore dhe mbajti afër intelektualët, ku fryma kombëtare ishte e pranishme në të gjitha veprimtaritë. Në fund të vitit 1944, regjimi serb, e burgos përsëri. Pas burgut, vendoset në teqenë e Gjakovës. Kështu, Gjakovën, i vetmi qytet në trojet shqiptare ku mund të predikohej bektashizmi, e mbajti gjallë baba Qazimi. Aty bashkëpunoi me baba Tajar Gashin, me teqenë e Detroid SHBA. Gjithë jetën punoi me përkushtim dhe la gjurmë si patriot, mësues dhe klerik i shquar. Baba Qazimi ishte njeri i ditur, i kulturuar merrej edhe me shkrime dhe përkthime, gjithashtu kishte ndjenja të fuqishme atdhetare. Ndërroi jetë më 15 shkurt 1981.

Ndaj sot të nderuar pjesëmarrës në këtë ceremoni të veçantë të këtij përvjetori përkujtojmë këtë klerik të shquar të bektashizmit që kontribuoi në të gjitha trevat Shqipfolëse me shumë dashuri, mençuri, urtësi, e trimëri. Zoti na bekoftë të gjithëve ! Amin!





Nga Lorik BAKIJA

Historiani, shkrimtari e veprimtari i njohur, Jusuf Buxhovi vizitoi Teqenë Bektashiane të Gjakovës. Në takim me Dervish Rrauf Radoniqin, Buxhovi shprehu mirënjohjen e tij ndaj kontributit të bektashinjve, dhe tha se vlerëson misionin e bektashinjve.

Jusuf Buxhovi dhuroi për Bibliotekën e Teqesë veprat, autor i të cilave është, përfshirë kompletin "Kosova" dhe ndër të tjerë, librin "Jeniçeri i fundit".

Dervish Rraufi i Teqesë së Gjakovës, në emrin personal, në emër të anëtarësisë dhe

veçanërisht në emër të Kryegjyshit, Dede Baba Edmond Brahimajt shkrimtarit Buxhovi i uroi shëndet e jetë të gjatë me përplot vepra të tjera autoriale.

Biblioteka e teqesë së Gjakovës, e kthyer në dekada të tëra në një qendër fetare e atdhetare, kishte në inventarin e saj, një pasuri të vyer dokumentare e tituj librazh,

por në luftën e Kosovës, serbët i vunë flakën godinës, ku u dogj dhe biblioteka. Ringritja e funksionimi i këtij institucioni u shoqërua dhe me pasurimin e bibliotekës. Me interesin e veçantë të Kryegjyshit Botëror, Dede Edmond Brahimaj, janë siguruar e vendosur në bibliotekën e kësaj teqeje, libra e dokumente të vjetra, si dhe tituj të librave bashkëkohorë.

JUSUF BUXHOVI DHURON LIBRA PËR BIBLIOTEKËN E TEQESË SË GJAKOVËS-KOSOVË



Dede Edmond Brahimaj, në takim me funksionarë të lartë të Këshillit të Europës

KRYEGJYSHI BOTËROR, HAXHI DEDE BABA, EDMOND BRAHIMAJ, U PRIT NGA DREJTUES TË KABINETIT TË PRESIDENTIT TË KËSHILLIT EVROPIAN ANTONIO COSTA

Ditën e enjte, më 27 shkurt 2025, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij Haxhi, Dede Baba, Edmond Brahimaj, zhvilloi një takim të nivelit të lartë me drejtuesit e kabinetit të z. Antonio Costa, President i Këshillit Evropian.

Në këtë takim u fol mbi projektin e qeverisë Rama mbi statusin politiko-juridik Bektashi, mbi projektet e Kryegjyshit Botëror me BE-në, gjithashtu dhe për rolin që këto projekte synojnë të kenë në të 33 shtetet ku shtrihet Bektashizmi. Ndër të tjera, Kryegjyshi Botëror,



Nga takimi me personalitete të KE

Dede Edmond Brahimaj u ndal tek vlerat dhe vizioni i Kryegjyshit Botëror, të cilat janë në harmoni të plotë me ato të Bashkimit Evropian. Drejtuesit e kabinetit, u shprehën

falenderues për këtë vizitë dhe të lumtur që Kryegjyshata Botërore mund të punojë për më shumë paqe, harmoni, vlera kulturore, demokraci e prosperitet në vendet kandidate dhe më gjerë.

DOLI NGA SHTYPI LIBRI “BEKTASHINJTË SHQIPTARË NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE”

KONTRIBUTI I KLERIT BEKTASHIAN NË ÇLIRIMIN E ATDHEUT- RASTI I DEDE AHMETIT

Haxhi Dede Baba, Edmond BRAHIMAJ

Kryegjysh Botëror i Bektashizmit

Jam i nderuar që sot do të kumtoj në ligjëratën time për një figurë të lartë të bektashizmës Shenjti Dede Baba Ahmed Myftari, klerik patriot, atdhetar, paqedashës. Kontributi i klerit bektashian është parë në të gjithë vijën e historisë së njerëzimit. Kjo ka filluar me masakrën e parë, që ka ndodhur me Sulltan Mahmutin e Dytë i cili i ka vrarë më shumë se 1 milion Bektashinj, e më pas me persekutimin e Ataturkut, Qendra Botërore u shkëput nga Turqia dhe ishte Sali Njazi Dede që e sjell fillimisht në Korçë e më pas më 1930 në Tiranë, ku vazhdon të jetë edhe sot Selia e Shenjtë e Kryegjyshit Botëror Bektashian. Bektashizmi u persekutua nga Perandoria Osmane dhe në shkrime gjejmë citime të prijësit Bektashinjve Haxhi Bektash Veli “Perandoria juaj po vazhdoi me parimet e bektashizmit, pa vrarë, kanosur, pushtuar popuj e duke i robëruar ata, do jetë e pathyeshme, e në rast se do të bëjë të kundërtën atëherë do të kthehet atje ku ka qenë në fillim. “Dhe historia e vërtetoi....

Ataturku u mundua ta mbrojë Turqinë nga shpërbërja si shtet, ku dhe Bektashinjtë shqiptarë dhanë një ndihmesë të madhe për mbarëvajtjen e shtetit turk siç janë Rilindasit Shqiptarë vëllezërit Frashëri, Sami Frashëri shkruesi i Enciklopedisë Turke dhe kontribues në Fjalorin e gjuhës Turke. Edhe gjatë periudhës Komuniste Bektashizmi ka luajtur një rol të rëndësishëm për të mbajtur gjallë besimin. Janë persekutuar shumë baballarë, shumë dedelerë edhe shumë

dervishë, të cilët për të mbrojtur Teqetë për të mbrojtur Kombin, atdheun, për të mbrojtur të vërtetën, për të mbrojtur të drejtën, dhanë edhe jetën.

Me ardhjen e Bektashizmit në Shqipëri, e më vonë Lufta e Dytë Botërore solli shumë pasoja, përfshirje të klerikëve në çlirim e vendit nga okupatori me divizën “Pa atdhe nuk ka fe”. Një nga këto figura të shquara është edhe Shenjti Dede Baba Ahmet Myftari. Kontributi i tij i çmuar është pasqyruar në disa botime të cilat i gjeni edhe në bibliotekën e Kryegjyshit Botëror Bektashiane.

Dede Ahmeti ka lindur më 22 shkurt të vitit 1916, në fshatin Brataj të Vlorës. Mësimet e para në shkollën fillore, i mori në shkollën e fshatit ndërsa të tjerat, në qytetin e Vlorës. Mbeti jetim qysh herët, por mundi të trashëgojë prej prindërve, dashurinë për dije, dashurinë për atdheun. Prej të afërmeve të vet, u mëkua më pas, me dashurinë për besimin e kulluar bektashian. Mbaroi shkollën qytetase në vitet 1924-1929 në Vlorë. Më pas shkon ushtar në Dibër në vitin 1936. Këtu u njoh me baba Zenel Dume nga Çepani i Skraparit dhe mori dashurinë dhe besimin te i Madhi Zot, mori njohuri për bektashizmin

dhe islamin në përgjithësi, ku qëndroi në teqenë e Bllacës në vitet 1937-1939. U vesh dervish në teqenë e Bllacës nga Baba Zeneli në teqenë e Bllacës qëndroi dhe shërbeu si dervish nën drejtimin e baba Zenelit në vitet 1937-1939. Ishte vetëm 22 vjeç kur vishet dervish prej baba Zenelit të teqesë së Bllacës në Dibër dhe bën betimin e shenjtë, për t’i shërbyer rrugës





Dede Edmond Brahimaj, duke mbajtur kumtesën

së Hakut, deri në frymën e fundit. Një vit më vonë, në qershorin e vitit 1939, ashtu sikundër dhjetëra klerikë të tjerë bektashianë, u rreshtua në krahun e luftëtarëve të lirisë, në aksione konkrete kundër pushtuesve italianë. Në Vlorë dhe Kurvelesh, në Tepelenë dhe Elbasan, fjala e dervishit bektashian zinte vend në zemrat e luftëtarëve. Ajo fjalë ngrohte si dielli në dimrat e atyre viteve dhe ndizte zjarre shpresash të mëdha, shpresash se një ditë do të jetonin të lirë dhe të pavarur, me besimin e palëkundur në Zot.

Veprimtaria atdhetare e dervish Ahmetit Myftarit, bie në sy të autoriteteve italianë. E thërrasin dhe i thonë duhet të heshtë, duhet të shkoj në teqe dhe të kujdeset për besimtarët. Ky i dëgjon dhe në heshtjen e thellë u përgjigjet: *“Si mund të kujdesem për besimtarë me vatan të shkelur. Vatani njëherë, ai të jetë i lirë, pastaj vjen besimi!”*. Në fillim të majit të vitit 1943 e arrestojnë dhe e dërgojnë në kampin famëkeq të “Porto-Romanos”. Edhe këtu shpirti i lirë i tij, nuk gjen prehje. Fjala e ngrohtë e tij, bind komunist dhe nacionalistë se përpara çdo lloj bindjeje partiake është atdheu. Atij do t’i falemi në çdo kohë, me çdo mjet, në çdo situatë. Me kapitullimin e forcave italiane e lë kampin e “Porto-Romanos” dhe sërish, me pushkë në krah, renditet në radhët e luftëtarëve të lirisë. Pranvera e vitit 1945, e gjen në detyrën e komandantit të Qarkut në Martanesh dhe përpara tij çelen dyert e karrierës ushtarake. Provat i

kish, aty në vijën e parë, në zjarrin e betejave. Madje në një prej këtyre betejave u plagos rëndë. Shokët e morën

në supe e dërguan në spital, duke i rikthyer jetën. Gjithsesi brenda zëmrës së Ahmet Myftarit, gjallonte ëndrra e dervishit, besa që pat dhënë dikur, në mejdan të teqesë së Bllacës. Me shkrimin e tij të bukur, falënderon komandën e lartë për besimin që i kish dhënë dhe në maj 1945, paraqitet në Selinë e Shenjtë të Kryegjyshit Botërore Bektashiane, duke hedhur në supe harkanë e dervishit bektashi. Më 2 tetor 1945, merr titullin baba dhe shërben plot devocion në teqetë e Baba Hamitit-Elbasan si edhe Kuzum Baba në Vlorë. Në 2 qershor 1948, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Bektashian, vendoset në funksionin më të lartë, atë të Kryegjyshit Botëror Bektashian. Kurse në vitet 1948-1958 organizoi arsimin fetar, u përkthye në gjuhën shqipe dhjetëra libra për bektashizmin. Në këto vite i dha hov bektashizmit dhe u bë faktor i harmonisë fetare midis komuniteteve fetare tradicionale në Shqipëri. Zgjidhi një varg detyrimesh të Komunitetit Bektashian Shqiptar me bektashinjtë e tjerë në gjithë botën.

Vitet e qëndrimit të dede baba Ahmet Myftarit, në këtë post të rëndësishëm, janë vite të gjallërimit të mëtejshëm të besimit bektashian, vite të respektimit të tri erqanëve tradicionale, duke larguar njëherë e përgjithmonë këtë besim të mrekullueshëm, nga kurthet dhe prapësitë e thurura prej partisë-shtet. Në këto vite, portat e teqeve u çelën për mijëra dashamirës dhe myhib, u institucionalizua arsimi fetar, u nxorën prej arkivave dhjetëra libra për bektashizmin dhe u përkthye në gjuhën

VIJON NË FAQEN 28 >>

<< VIJON NGA FAQJA 27

shqipe dhe zëri i bektashizmit u dëgjua më larg se kurrë. Në Konferencën Ndërkombëtare “Apel Paqes” në Tiranë në vitin 1956, shpalosi mendimet në referatin e Perëndisë, mbas kësaj filloi lufta ndaj tij nga partia-shtet. Pikërisht kjo gjë nuk mund t’i pëlqente partisë-shtet e cila thuri rrjetën e merimangës dhe me ndihmën e segmenteve të caktuar të sigurimit famëkeq të shtetit, bëri që dede baba Ahmet Myftari të linte postin e rëndësishëm dhe të kalonte privacionet në vitet e rënda të internimit të dede Ahmetit dhe dervish Reshatit, në Drizar të Mallakastrës. Privacionet dhe torturat u bënë pjesë e pandarë e jetës së tyre. Por edhe në këto kushte, të dy këta shenjtore, rrëfyan shpirtin e madh dhe të paepur, rrëfyan vendosmërinë e palëkundur për ta mbajtur të pastër burimin e besimit bektashian.. Ashtu siç kanë pohuar të tjerë besimtarë, përpara nesh, teqeja e Drizarit, u shndërrua në të vërtetë në Selinë e Shenjtë të Kryegjyshitës Botërore Bektashiane. Një meritë e padiskutueshme gjithashtu e dede Ahmetit, është fakti që frymën e tij, shenjtërinë e tij të panjollësuar, ai përcolli plot dashuri në personalitetin e dede Reshat Bardhit. Ky me përkushtimin e vet, me fuqitë e dhuruara nga Zoti, mundi të mbante gjallë besimin tonë edhe në momentet më të vështira, ato të pas viteve 1967. Në këtë periudhë teqeja e Drizarit u shndërrua në Seli e Shenjtë të Kryegjyshitës Botërore Bektashiane. Ndërroi jetë në 10 korrik 1980.

Dede Reshati thotë për myrshidin e tij, Dede Ahmetin: “E njoha Dede Ahmetin kur isha 17 vjeç. Ai hyri në jetën time dhe do të mbetet aty, deri në frymën time të fundit. Ai më mori për dore dhe më futi në rrugën e ndritur të bektashizmit, në rrugën e ndriçuar prej Pirit tonë Haxhi BektashVeliu. Dede Ahmeti ka qenë dhe mbetet një gur i rëndë në themelet e bektashizmit shqiptar dhe atij botëror. Me urtësinë e tij, me zgjuarsinë e tij, me guximin e tij, Dede Ahmeti për dhjetë vjet rresht, mbajti mbi shpatulla një varg problemesh me të cilat përballë bektashizmi ynë i kulluar. Ai kurrë nuk u qa, kurrë nuk u ankua, kurrë nuk e lëshoi veten edhe në situatat më të vështira. Në mënyrë të veçantë, kurajua dhe guximi i tij, shkëlqyen në vitet e vështira të internimit, në fshatin Drizar të Mallakastrës. Aty u shfaq si rrallë herë qëndresa e tij. Teqeja e vogël e Drizarit, ai vend i humbur mes përrallesh, u bë Selia e Shenjtë e Kryegjyshitës Botërore Bektashiane. Te kjo teqe kanë ardhur me mijëra besimtarë, nga e gjithë Shqipëria. Vinin të rraskapitur, vinin të trishtuar, vinin si nata. Po iknin të çlodhur, iknin të gëzuar, iknin si mëngjesi i bukur. Dede Ahmeti u jepte shpirt dhe dritë nga shpirti dhe drita e tij. Ligjet e regjimit në fuqi, nuk mund të vepronin përballë ligjeve hyjnorë.

Dede Ahmeti drejtoi Kryegjyshitën Botërore Bektashiane 10 vjet (1948-1958). Në këto vite u bë faktor i harmonisë fetare midis komuniteteve fetare tradicional në Shqipëri dhe lidhjet me komunitetet bektashian në gjithë botën.

Ai institucionalizoi arsimin fetar, u përkthyen, në shqip dhjetëra libra për bektashizmin. U internua së bashku me dervish Reshatin, në Drizar të Mallakastrës nga shteti monist në vitin 1958. Ai mbetet një figurë e shquar për bektashizmin në Shqipëri dhe në botë.

Busti i tij hijeshon në qytetin e Vlorës dhe vendlindjen e tij në fshatin Brataj. Është shpallur “Qytetar Nderi” i Vlorës. Albapost, në ciklin e figurave të shquara për vitin 2001, ka emërtuar në emisionin e pullave Ahmet Myftar Dede. Janë botuar broshura, libra për jetën dhe veprën e tij, përgatitur filma, dokumentarë dhe kalendarë. Ai mbetet një figurë e shquar kombëtare dhe me vlera të mëdha për bektashizmin. Në kujtimet e Tij “Dede Ahmeti i gjallë mes nesh”, Baba Selim Kaliçani do të shkruante: Dervish Ahmeti në Elbasan dhe ngjarjet e luftës.....

“.... Dede Rizai mbeti tepër i kënaqur me dervishin e ri dhe sipas propozimit që i bëri, që të nesërmen e dërgoi zëvendës baba në teqenë e Baba Hamidit në Elbasan, te pusi që lahet vetë. Teqeja dispononte shumë materiale dhe dervishi i shfletoi dhe mori shumë njohuri prej tyre. Gjithashtu si zot shtëpie që ishte, filloi të shërbejë me gjithë shpirt ne teqe, saqë muhibët e ashikët filluan që të kenë për të një dashuri dhe respekt te madh. Si i ri që qe dhe me shpirt atdhetari, pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste e shikoi me një urrejtje të thellë. Fshehurazi filloi të aktivizohet në luftën kundër pushuesit bashkë me shumë të rinj të tjerë me ide patriotike dhe, si të thuash, kjo teqe qe jo vetëm një vend përkushtimi fetar, por dhe një çerdhe e luftëtarëve të rinj. Aktiviteti i kësaj celule ra në gjurmë të kuesturës fashiste dhe në prill 1942, 13 prej tyre, bashkë me dervishin i arrestojnë dhe i dërgojnë në kampin e përqendrimit te Plepë e Durrësit, me qëllim për t’i dërguar të internuar në Itali. Në atë kohë Jakomoni ishte zëvendës mbret i Viktor Emanuelit në Shqipëri, kurse Kryeministër qe Mustafa Merlika (Kruja). Ngjarja u mor vesh nga dede Rizai dhe me të shpejtë u aktivizua për lirimin e dervish Ahmetit. Dedej me thotë: “Bëj gati makinën se pasdite do të shkojmë te shtëpia e Kryeministrit për t’i bërë një vizitë shoqërore!”

Një orë para se të perëndonte dielli ne qemë të pranishëm te shtëpia e Mustafait. Qe një vizitë surprizë ku na pritën me mjaft përzemërsi. Pasi shkëmbyen pyetjet e para të takimit, Dedej menjëherë i thotë Kryeministrit: “Kam ardhur të më lirosh djalin (dervishin), sepse duan të ma internojnë në Itali.” Zotëria i tha: “Nuk i futem dot kësaj pune, se me të merret direkt Jakomoni.” Gjatë bisedës morën pjesë dhe anëtarë të familjes Merlika dhe të ndikuar dhe nga thëniet e tyre, Mustafai tregoi shpirt dhembshuri e tha: “Unë po mundohem, megjithëse garanci nuk jap.” Pas këtyre fjalëve, të cilat Nazarit i dhanë një farë shprese, u larguan. Dervish Ahmeti sa ngrihet nga gjumi i thotë shokëve të kampit: “M’u dha sihariq nga Zoti i Lartë, se sot në orën 7 do të lirohem.” Të gjithë filluan të qeshin, se asnjëri s’i besoi fjalët e Tij. Pas dy orësh shakaje, në dhomë të kampit futet gardiani dhe me zë të lartë thërret:



“Dervish Ahmet Brataj, të marrë rrobat e të dalë.”

Shokët u mahnitën, panë orën 7 fiks dhe tani besuan në shenjtërinë e tij e me lot në sy, u ndanë nga dervishi. Që në ditë të një lëvizjeje të madhe patriotike dhe urrejtja për fashizmin çdo ditë shtohet më tepër. Atdheu thërriste rininë për luftë për çlirimin e vendit Bektashinjtë gjithmonë kanë qenë patriotë dhe me pushkë dhe penë kanë luftuar për lirinë e atdheut dhe popullit. Dervish Ahmeti që jo vetëm i përkushtuar në rrugën e Hakut, por dhe në shpirt i vlonte ndjenja e atdhedashurisë si dhe disa klerikëve të tjerë a muhibëve të vërtetë që nga Rilindja e deri në këto dite. Naimi në vjershën “Korça” në fq. 48 shkruan:

*“S’jemi grekër as bullgarë,
Asgjë tjetër nuk jemi,
Jemi vetëm shqipëtarë,
Ne këtë emër nder e kemi...”*

Po ky poet dhe myhib i bektashizmit urrejtjen ndaj tradhtarëve të vendit e shpreh në vjershën “Tradhtarët”.

*“Bukë e mëmëdheut zëntë,
Tradhtarët e pabesë,
Dhe Zoti derman u dhëntë,
kurrë, mos paçin pjesë...”*

Kurse nga libri “Besimi e atdheu”, botuar me 1933 prej dervish Rizaît të Leskovikut me vjersha të baba Meleq Shemberdhenjit mes tyre, shkëputëm vargjet:

*“Dashurinë e mëmëdhesë,
Që kur lind, gjersa të vdesë,
Njeriu të mos e presë...”*

Dervish Ahmeti i vlonte në deje ndjenja e atdhedashurisë, që asnjëherë s’e ndante nga përkushtimi fetar e, për këtë

doli në mal partizan dhe u inkadrua në çetën e Pezës. Në luftë me armiq të pushtues dervishi i ri u plagos dhe për shërim u strehua në Kryegjyshatë, në një vend të sigurt. Thirrjes për çlirimin e vendit ju përgjigjen dhe shumë klerikë të tjerë, që urrenin pushtuesit gjakatarë. Meqë Tirana jetonte në shtetrrethim, guerrillasit e qytetit e morën dervish Ahmetin dhe e dërguan në lagjen “Brakaj” për ta kuruar, ngaqë këtu nuk binte ne sy dhe për të mos e njohur, hoqi rrobat e dervishit dhe u bë civil. Meqë më 1944 teqeja që e djegur, dervish Ahmeti shërbente si komandant poste këtyre anëve dhe, pasi kishte mbledhur batanijet dhe gavetat e italianëve, i sjell ne teqe, shtron batanijet në tyrbë dhe njofton se do të këndonin Hadikanë, të shkruar me dorë... *“Njihe veten tënde o Njeri përpara se të perëndosh...”* -Dede Ahmed. Në konferenca e Paqes më 1949 në Tiranë Dede Ahmet Myftar Ahmataj do t’i drejtohej këtij tubimi madhështor me oratorinë e lartë dhe përlulesinë e shenjtëruar. “... Besimi i shenjtë tek një Zot i vetëm dhe i pashoq, na ka sjellë sot në apelin e paqes. Shpreh mirënjohjen time më të thellë, si lider shpirtëror i Bektashizmit, që në emër të Komunitetit Bektashian të përshëndes këtë konferencë ndër fetare të paqes. Promovimi i paqes dhe stabilitetit të saj, duhet të ndihmojë kohë pas kohe jo vetëm brenda trojeve tona shqiptare, por në mbarë botën. Paqja ishte dhe do të mbetet misioni ynë

...Naimi i Madh, ky bilbil i bektashizms, në Fletoren Bektashiane shkruan:

*-Besa e bektashinje është,
Udhë e gjerë, që ka përpara,
Dritën, urtësinë, vëllazërinë,
Miqësinë, dashurinë,
Njerëzinë dhe gjithë mirësitë.
Me një anë ka lulet e diturisë,
Në anën tjetër të së vërtetës.
Detyra jonë është,
Të paqësojmë njeriun,
të përkujdesemi për varfërinë,
Të mërgojmë ligësitë e marrëzitë,
Të mos kemi lakmimin dhe madhështinë,
Babëzinë, të rremat dhe gjithë të këqijat,
Që janë jashtë udhës së njerëzisë...”*

Ne e kujtojmë Dede Ahmetin në pafundësinë e kohës, me nderim jo vetëm emocional apo ceremonial, por me një nderim të ditur. Nderim për klerikun, atdhetarin, filozofin dhe bektashianin e spikatur. Dede Ahmeti ka mbetur apel i kohës në kohë ... Adhuresit e Dede Ahmetit vetëm lindin dhe kurrë nuk vdesin. Është e vështirë të flasësh për të thjeshtin, besimtarin e urtë, njeriun e përvuajtur me një plotfuqishmëri ringjallëse. Ai është vetëdija dhe njëherazi lidhja me të tjerët. Ai është një botë, e cila përbën universin e plazmuar në traditat paraardhëse të besimit në udhën e Zotit të madhërisëm. Vepra e Tij është arti i të menduarit. Është perandoria e virtytit. Gjatë gjithë

VIJON NË FAQEN 30 >>

PREZANTIM I SHKURTËR I LIBRIT

Libri i sapodalë nga shtypi, “Bektashinjtë shqiptarë në Luftën e Dytë Botërore”, përgatitur në përkujdesjen e mbështetjen

e Shenjtërisë së Tij, Haxhi Dede Baba Edmond Brahimaj, sjellë dokumente e dëshmi tejet interesante të kontributit të klerit bektashi në Luftën e Dytë Botërore. Si bazë e tij janë studimet e kumtesat e studiuesve, Haxhi Dede Baba, Edmond Brahimaj; Prof. Skënder Gjinushi; Prof. Hamit Kaba; Prof. Bektash Mema; Nuri Çuni; Naim Deraj; Prof. Bernard Zotaj; Prof. Marenglen Kasmi etj, mbajtur në Konferencën Shkëncore, zhvilluar në Akademinë e



Shkencave të Republikës së Shqipërisë, më 19 nëntor 2024. Referencat përkatëse dhe dokumentet zyrtare që përfshihen në libër, japin detaje të reja interesante

lidhur me misionin atdhetar, pjesëmarrjen direkt të klerikëve bektashinj në këtë luftë (disa, heronj dhe dëshmorë të vendit), si dhe kthimin e objekteve bektashiane në qendra arsimit e atdhetarie.

Ky libër, është pjesë e angazhimeve dhe masave tërësore, për projektin e ri, (me mbështetje shtetërore e faktorëve të tjerë) për hapësira më të mëdha e

rol më efektiv të besimit të paqtë bektashian.

K. BORIÇI

jetës së vet, jetoi duke mohuar vetveten, duke dashur të tjerët. Kjo për Atë përbënte marrëveshjen më të madhe, dhe kishte bërë me vetveten në udhën e përkushtimit, ligjësi të cilën e konfirmoi në jetë. Kjo domosdoshmëri madhore e bëri Atë të gjeneronte mendimin e veprimin human. “- Ne,- thoshte Dede Ahmeti, do të mund t’u shërbejmë besimtarëve nëse duam vetveten dhe do të dimë që nëpërmjet vetes të respektojmë ata që jetuan para nesh dhe na mundësuan jetën.” E donte udhën e urtë, e donte besimin. Endet edhe sot shpirti i Tij ndër besimtarë. Ai, shtegtar i mërguar, histori e paharruar. “Njeriu duhet të jete i ndërgjegjshëm për rrugën që zgjedh dhe konsekuent në zgjedhjen që bën. Shërbëtor i shërbëtorëve. Dede Ahmet Myftari”

Vlerësimet për Dede Ahmetin në vite:

- Nga Presidenca, Urdhri për Veprimtari Patriotike të Klasit I (pas vdekjes) 16.07.1993
- Qytetar Nderi i Vlorës (pas vdekjes) 30 .10. 2000
- Figurë e shquar në emetimin e pullave, Albpost 2001
- Personaliteti i Labërisë, nga Shoqata “Labëria”, 25.02. 2014
- Nga Presidenca, “Nderi i Kombit” (pas vdekjes), 22 shkurt 2016
- “Qytetar Nderi i Komunës Brataj” (pas vdekjes),

gusht 2016

- Vendosja e bustit në Qytetin e Vlorës...
- Vendosja e Bustit në Brataj, 2011
- Vendosja e Bustit në Krujë, dhjetor 2021
- Botime librash dhe filma.

Burime

- Arkivi i Shtetit.
- Amataj, Kujtim: “Shenjtë Këmbzbathur”, Tiranë
- Ahmataj, Kujtim: “Shërbëtar i Harkasë”, Tiranë
- Baba Selim Kaliçani: Dede Ahmeti i Gjallë mes nesh”, Tiranë
- Cuni, Nuri & Deraj, Naim: “Bektashizmi në Tepelenë Tiranë 2023, fq. 106-109.
- Revista “Urtësia”: Nr. 25, shkurt 2001, nr. 30 gusht 2002, Nr. 84 gusht 2011, nr. 111 shkurt 2016, Nr. 123 dhjetor 2017, nr. 123, shkurt 2022, nr. 146 shtator 2022.
- Album fotografik, shkurt 2016.
- Elsie, Robert: “Bektashinjtë Shqiptar, Historia dhe kultura e një rendi dervishësh në Ballkan.’ Tiranë 2020, fq. 604-605.



Selia e Kryegjyshit Botërore Bektashian, Tiranë.

Veprimtaritë e Kryegjyshit Botërore Bektashiane, janar - shkurt 2025

- ♦ 14 janar: 14-17 janar, përvojtori i 104, i mbajtjes së Kongresit të Parë Bektashian, në teqenë e Prishtës Skrapar.
- ♦ 20 janar: -Nisma e Kryeministrit për krijimin e “Shtetit sovran bektashian,, Papa Françesku” “E bekoj këtë nismë të bukur,”. (shkrimi në gazetën “Panorama”, nga Ferdinand Samarxhi).
- ♦ 25 janar:-Mesazh ngushëllimi i Kryegjyshit Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Baba, Edmond Brahimaj, për kalimin nga jeta të Kryepeshkopit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlunturisë së Tij, Anastas Janullatos.
- ♦ 25 janar: -Zhvillohet aktiviteti për 95-vjetorin e vendosjes së Kryegjyshit Botërore Bektashiane në Shqipëri. Ky përvojtor i shënuar, përkon me një ndërmarrje tejet të rëndësishme për një status më të plotë zyrtar të këtij besimi të plotë, me shtrirje numerike e gjeografike, pothuaj në gjithë botën. Përshëndetja e Kryegjyshit Botëror, Dede Edmond Brahimaj dhe Kryeministri Edi Rama.
- ♦ 27 janar:-Përkujtohet 4-vjetori i kalimit nga jeta, i baba Mumin Lama, në teqenë e Gjakovës në Kosovë. Merr pjesë Kryegjyshi Botëror Bektashian, Dede Edmond Brahimaj.
- ♦ 28 janar:-95 vjet nga ardhja në Shqipëri e Kryegjyshit Botëror Bektashian, Sali Niazi Dede.
- ♦ 29 janar:- Kryegjyshi Botëror merr pjesë në homazhet në nderim të Kryepeshkopit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlunturisë së Tij, Anastas Janullatos.
- ♦ 3 shkurt:-Takimi i Kryegjyshit Botëror, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Baba, Edmond Brahimaj, me ambasadorin e OKB-së në Shqipëri, Fiona Mçluney.
- ♦ 4 shkurt:- “Projekti i ri bektashian”, në gazetën “Telegraf”. Fjala e Kryegjyshit, Dede Edmond Brahimaj dhe Kryeministrit Edi Rama, për 95 vjetorin të Kryegjyshit Botërore Bektashiane në Shqipëri.
- ♦ 7 shkurt:-Zhvillohet ceremonia e lamtumirës, të baba Hekuran Nikollarit të teqesë së Alipostivanit-Përmet.
- ♦ 13 shkurt:- Zhvillohen ritet e 7 ditëve të përcjelljes nga kjo jetë, të baba Hekuran Nikollarit.
- ♦ 14 shkurt:- Përkujtohet 31-vjetori i kalimit nga jeta, i baba Sherif Canometaj dhe 7-vjetori i kalimit nga jeta, i baba Ismail Jangullit.
- ♦ 15 shkurt:-Përkujtohet 44-vjetori i kalimit nga jeta, i baba Qazim Bakallit, në teqenë e Gjakovës-Kosovë.
- ♦ 17 shkurt:-Kryegjyshi Botëror Bektashian, Dede Edmond Brahimaj, mesazh urimi për 17-vjetorin e pavarësisë së Kosovës.
- ♦ 22 shkurt:-109-vjetori i lindjes së Dede Ahmetit, ish-Kryegjyshit Botëror Bektashian.
- ♦ 22 shkurt:-Përkujtohet 81-vjetori i ndarjes nga jeta, i ish-Kryegjyshit Botëror Bektashian, Riza Ali Dede (1876-1944).
- ♦ 24 shkurt:-Mesazh i Kryegjyshit Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Baba, Edmond Brahimaj, për shërim të shpejtë e të plotë, të Papa Françeskut.
- ♦ 28 shkurt:-Kryegjyshi Botëror, Haxhi Dede Baba, Edmond Brahimaj takohet me drejtues të kabinetit të Presidentit të Këshillit Evropian Antonio Costa.

RUBRIKA: **Mistika Bektashiane**

MISTICIZMA ISLAME DHE BEKTASHIZMA

Nga Baba REXHEBI

(Vijon nga numri i kaluar)

Hysejn bin Mensur el Hallaxhi ...“Sa për teorinë e tij mbi misticizmin, Hallaxhi e ka shfaqur vetëm herë në vjershë dhe herë në prozë dhe është përqendruar më shumë në tri pika: E para është Ndërhyrja Hyjnore në botën njerëzore; e dyta është përjetësia e Esencës Muhamedane. Kjo domethënë që të gjitha lartësitë praktike ose teorike andej e kanë burimin. Kjo ka kuptim gjithashtu se kjo esencë ka shkaktuar dhe krejt krijesën e universit mbarë. E treta është teoria e tij mbi bashkimin e të gjitha feve në parim, pse të gjitha kanë dalë nga burimi i një Zoti të vetëm.

Përsa i përket teorisë së parë, një shok i kohës së tij, Ashariu, thotë: “Hysejn bin Mensuri, i njohur me emrin Hallaxh, është nga qyteti Bejza. Ky u mor më parë me regjien e lëkurëve (siç ka kuptimin fjala Hallaxh), pastaj hyri në zahidizmë

dhe, duke përparuar në këtë, arriti në përfundim se kushdo që merret me punë të mira dhe veten e zemrën i stërvit dhe i edukon siç duhet, i reziston mërgimit nga shijet e kësaj bote, frenon epshin nga çdo gjë e ndaluar arrin në pozitën e të afërmve të Zotit. Më pas, duke ngjitur shkallët e miqësisë me Zotin, pastrohet dhe zhvishet nga natyra njerëzore fare. Kur s’i mbetet asnjë thërrime nga kjo natyrë, del fare nga faza

e njerëzimit. Atëherë hyn tek ai fryma hyjnore, si dhe tek Isai, të birit të Mjerimit, dhe çdo gjë i përulet atij. Ç’të kërkojë i plotësohet. Në atë rast çdo punë e këtij është punë e Zotit dhe çdo urdhër i tij bëhet urdhëri i Perëndisë”. Ky është, pra, kuptimi i besimit dhe i fjalës së Hallaxhit “Hyrja tek Zoti” (hulul). Domethënë se në këtë mënyrë Zoti hyn tek njeriu dhe vullneti i njeriut atëherë nuk është gjë

tjetër, përveç se vullneti i Zotit. Hallaxhi, në bazë të kësaj teorie, që Zoti me mënyrën e sipërtreguar hyn tek njeriu i përsosur, domethënë i dashuruari hyn tek dashuruesi, nxori vijën e tij të posaçme dhe thotë: “Unë jam dashuruesi dhe i dashuruari unë jam. Që të dy bashkë jemi dy shpirtra që jemi futur në një kraharor. Kush shikon mua ka shikuar Atë dhe kush shikon Atë na ka shikuar të dyvet”. Me këtë rast i kthehet të dashurit të tij dhe i thotë: “Ti po hyn brenda në zemrën time, siç hyjnë dhe shpirtrat nëpër kraharorët. Hallaxhi, si i mbytur që është në dashurinë e Zotit, kur shpjegon këtë hyrje të të dashurit



në shpirtin e tij, herë-herë është i gëzuar që e ka aty dhe nganjëherë dyshon se mos nuk e ka Atë. Kur i duket që e kishte Atë, thoshte: *“Shpirtin tim me Tëndin e përzjeve, si verën me ujët e kulluar. Kështu që çdo gjë që të prek Ty, ka prekur njëkohësisht edhe mua. Në këtë mënyrë, unë dhe Ti bëhemi një”*. Me këto fjalë do të thotë se shpirti i Hallaxhiut me shpirtin e të dashurit të tij, u përzier si vera me ujët dhe u bënë një e të pandashme. Prandaj çdo gjë që i ka ngjarë njeriut, i ka ngjarë njëkohësisht edhe tjetrit. Por nganjëherë dyshon nga kjo përzierje dhe thotë: *“Unë s’jam Zoti vetë, jam sekreti i Tij. Mbase jam Zoti, por kam frikë se mos na ka hyrë ndarja. Unë, në çdo pamje, jam një me Zotin! Vallë në faqen e botës a duket ndonjë shenjë e njësimi t’onë?”* Hallaxhi, kur i drejtohej Zotit, i thoshte: *“O Zot! Siç është tretur humanizma ime në hyjnizimin tënd dhe nuk është përzier, ashtu dhe hyjnizimi Yt ka pushtuar gjithë humanizmin time, pa u përzier”*. Në një vend tjetër thotë: *“Gjithë ata që besojnë se përziehet hyjnizimi me humanizmin, ose humanizma me hyjnizimin, kanë dalë jashtë feje. Sepse Zoti i Madh, bashkë me cilësitë e Tija, është një i vetëm dhe krejt i ndryshëm nga krijatat e Tija dhe nga cilësitë e tyre. Asnjë gjë nuk i përngjan Atij dhe Ai vetë asnjë gjëje nuk i përgjan”*.

Dhe me këtë shprehje Hallaxhi është anëtar i bashkimit, por shquan dhe ndan hyjnizimin nga humaniteti, Zotin nga njeriu dhe të dashurin nga dashuruesi. Në këtë rast shtrohet pyetja se pse më parë Hallaxhi

e bashkoi hyjnizimin e Zotit me humanitetin njerëzor dhe i bëri një, dhe tani thotë ndryshe? A ka kontradiktë këtu apo jo? Përgjigja është jo, dhe ja pse: S’ka dyshim se Hallaxhi është i mendimit të unitetit, gjë e cila duket dhe është shprehur në çdo anë të rrugës së tij. Hallaxhi, duke qenë anëtar i unifikimit, thotë se njeriu, duke e zhdukur veten dhe duke e pastruar atë nga epshet materiale, bën të mundur që shpirti hyjnor të hyjë në shpirtin njerëzor. Dhe, siç është i vendosur shpirti i njeriut në kraharorin e tij, po ashtu edhe fryma hyjnore vendoset në shpirtin e njeriut. Dhe kështu, çdo gjë që del nga njeriu, çdo lëvizje e tij nuk bëhet me dëshirën e tij, por me vullnetin e Zotit. Por kjo nuk domethënë se Perëndia i ngjan njeriut, ose njeriu i ngjan Perëndisë, gjë të cilën Hallaxhi e ka shkoqitur vetë në një fjalë të tij: *“Njeriu, nga pikëpamja e gjendjes së tij origjinale, është një esencë hyjnore. Zoti njeriun e lartësoi dhe e krijoi në fytyrën e Vet. Dhe për këtë urdhëroi engjëjt që t’i përulëshin Ademit. Engjëjt të gjithë e zbatuan urdhrin e Zotit, përveç djallit (iblis), i cili, duke u bazuar në madhësinë (qibrin) e tij, nuk iu përul dhe u bë nga të mallkuarit e Zotit”*. (Shih kuranin, kap. Bekara, versi: 33). Pra, duke i bashkuar të dy interpretimet e Hallaxhit mbi njëjtimin, nuk mund të dalë kontradiktë.

* * *

Tani të vijmë në teorinë e dytë të Hallaxhi, mbi *“Esencën apo dritën Muhamedane”*. Këtë formulë Hallaxhi vetë në librin e tij *“Libri i Tavasinevet”*, e ka ndarë në pjesë të veçanta dhe e ka quajtur *“Drita e Trasinit”* (drita e formës së shkurtër kuranore), në

të cilën këtë çështje e shpjegon kështu dhe në këtë kuptim: Profeti Muhamet Mustafaj ka dy forma krijesash: Njëra është drita përjetuese e vjetër, e cila s’ka krye dhe kish qenë para çdo krijese tjetër. Dhe çdo dije ose njohuri ka ardhur nga kjo esencë. (Këtë tezë Hallaxhi e bazon edhe në fjalën hyjnore *“Hadithi Kudsi”*, që thotë: *“Levlaqe, levlaqe lema halaktul eflaqe”*, domethënë: Po të mos ishte Ti (o Muhamet) nuk do të kisha krijuar botën!. Forma e dytë është krijesa e fytyrës natyrale të Tij, kur erdhi në botë, siç dihet, dhe u bë profet dhe i dërguari i Zotit. Dhe kjo e dyta është e dukshme (fani). Kjo mënyrë ka qenë e vendosur qysh në fillim, prej kohe, të vinte në një vend të caktuar dhe në një kohë të prerë. Kështu, kur erdhi koha e vendosur, Profeti erdhi dhe kreu detyrën që i ishte ngarkuar, duke marrë njohuri dhe dritë nga ajo drita e vjetër, si në dije, ashtu dhe në veprim. Gjithashtu të gjithë profetët dhe shenjtoret e ardhur po nga kjo dritë janë ndriçuar dhe frymëzuar. Edhe vetë Profeti të gjithë dritën e profecisë nga kjo dritë e ka tërhequr. Dhe për të shpjeguar se *“Esenca Muhamedane”* është krijuar më parë nga çdo gjë, Hallaxhi thotë: *“Të gjitha dritat nga kjo dritë kanë lindur. Dhe drita e profetëve me këtë dritë është ndriçuar. S’ka dritë tjetër më të ndritur se kjo. Kjo është e vjetra mbi të vjetra. E forta mbi të fortat. Ekzistenca e saj është para Ademit. Emri i saj ishte shkruar para kalemit, pasi para çdo bote njerëzore kjo ekzistonte”*...

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Nga Divani Ali (607-644)

(Vazhdon nga numri i kaluar)

- ◆ Bëj pak durim, pasi një vështirësi ka me doemos një mbarim dhe çdo punë ka kohën dhe planin e saj.
- ◆ Zoti është mëshirues mbi veprimet tona; destinacioni i tij qëndron larg parashikimit tonë.

Sqarim: Në lidhje me fjalën e sipërme është edhe verseti kuranor që thotë: “Çdo dëshirë që keni juve, s’mund të realizohet pa urdhrin e Zotit”. Gjithashtu kemi edhe fjalën Profetike që thotë: “Robi parashikon dhe Zoti vendos”.

- ◆ Nëqoftëse të kafshon koha, duro, se ai që pret, i zbret çlirimi.

Sqarim: Në lidhje me vjershën e sipërme është edhe fjala Profetike që thotë: ”Prirja e çlirimit është një lloj falje!”.

- ◆ Ka shumë njerëz që janë në gjendje shëndetësore të mirë dhe ankohen; ka edhe shumë të sëmurë që i thyen pagjumësia.

Sqarim:-Në lidhje me këtë ashtë dhe fjala Profetike që thotë: “*I gjithë kombi im është i falur, me përjashtimin e atyre që ankohen kur preken nga fatkeqësitë*”.

- ◆ Nëqoftëse prekesh nga ndonjë fatkeqësi, duro, se në gjurmët e saj të vjen gëzimi.
 - ◆ Shumë njerëz janë që vuajnë nga gjaknxehtësia dhe nuk shohin gjumë në sy.
 - ◆ Ka dhe shumë njerëz që ngrysen të gëzuar dhe gdhihen të helmuar.
 - ◆ Ai që jepet pas kohës do të pendohet dhe do ta përbuzi këtë, pasi koha ka të mirat dhe të këqijat e saj.
 - ◆ O ti që kërkon lumturinë e kësaj jete! Pa hidhërime kërkesa jotë është e kotë, prite shpresën se nuk mund ta fusësh në dorë.
 - ◆ Dije mirë se jeta jote është një provë e cila provohet me të mira e të liga dhe me vështirësi e me lehtësi.
- Çfarë të mire gjen në botë që të mos jetë e shoqëruar nga një dëm, pasi ajo është e krijuar duke i pasur të dyja me vete.
- ◆ Frikshmëria është e turpshme, po vendosmëria



është e lavdëruar. Ai që irritohet nuk ka shpëtim nga destinacioni.

- ◆ Ata që janë të dëshpëruar nga zgjatja e gjendjes së turbullt të burimit, le të presin se do të kullohet dhe ka për t’jua shuar etjen e ujit.
- ◆ Ata që janë të paveshur, do të vishen dhe të dhunuarit e të poshtëruarit do të kenë një ditë të bardhë.
- ◆ Ata që janë keq-trajtuar do të gëzohen me përkëdhelje, dhe do t’ju shërohet plaga e zemrës krejtësisht.
- ◆ Mos u dëshpëro nga çdo e thënë që të vjen nga Zoti, sepse ai e ka në dorë të ndryshojë me

- ◆ lehtësi të keqen dhe të mirën.
- ◆ Nëqoftëse koha më hidhëron, unë do t'i bëj ballë me durim sepse çdo e keqe nuk është e vazhduar, kalon dhe bëhet e lehtë.
- ◆ Nëqoftëse koha më kënaq, unë nuk do t'a pres me gëzim, sepse gëzimi nuk është i vazhduar, të cilin e pason hidhërimi.
- ◆ Nëqoftëse koha më ka hidhëruar ndonjë herë, unë ia kam parë gëzimin më vonë, kur jam gjendur përpara një vështirësie, ma ka arritur menjëherë çlirimi.
- ◆ Unë kam kurdoherë një zakon që kur më prek hidhërimi, e duroj dhe kur më vjen ndonjë e mirë, e falënderoj.
- ◆ Kënaqësia e shpirtit është një pasuri për njeriun edhe sikur të varfërohet, vobekësia nuk e dëmton.

Sqarim: Në lidhje me vjershën e sipërme kemi edhe një tregim që është parë në librin “Garaifyl-xhami” i vërtetuar edhe nga shumë njerëz të mëdhenj dhe shokë të Hazreti Muhammedit, sipas të cilit Profeti ynë A.S. ka thënë: Një ditë nga ditët më erdhi vëllai im Xhebraili dhe pasi më pruri versete kuranorë, më transmetoi edhe këto fjalë nga ana e Zotit: “Ka disa njerëz nga njerëzit e mi, besimi dhe pohimi i të cilëve forcohet vetëm me pasuri, nëqoftëse unë i varfëroj, pasi ata dëmtohen, mbesin në mohim; ka edhe disa nga njerëzit e mi që besimi yt forcohet vetëm me vobekësi, dhe kur i bëj të pasur, ata mohojnë; janë edhe shumë të tjerë që besimi i tyre ju forcohet me sëmundje, të cilëve kur ju jap shëndet, bëhen mohues. Një pjesë tjetër e njerëzve të mi, ju forcohet besimi kur gëzojnë shëndet të mirë dhe mbesin në mohim, kur ju jap sëmundje, d.m.th., që njerëzisë kur nuk iu mungon njëra nga këto katër gjëra, e kanë besimin të shëndoshë, dhe kur ju mungon bëhen mohues”.

- ◆ Po hase në ndonjë vështirësi në jetën tënde, duroje se ajo nuk është e vazhduar edhe së shpejti të vjen çlirimi.
- ◆ Puna që bën mos të duket e vështirë, sepse çmimin e ka Zoti në dorë. Ajo që është e ndaluar nga Ai nuk të vjen dhe ç’është e destinuar për të ardhur, do të vijë.
- ◆ Në cilën ditë të iki nga vdekja, ditën që është më caktuar për të vdekur apo në ndonjë ditë tjetër.

- ◆ Nga dita e pacaktuar nuk trembem, por nuk kam pse ti ruhem edhe ditës së caktuar, së cilës s’kam se si ti shpëtoj.
- ◆ Ai që preferon të rrijë mënjatë, është i mungët dhe e lëshon veten pa dashur në pozitë të keqe.
- ◆ Çdo njeri çmohet sipas meritave që ka, ai që ndjek rrugën e drejtë quhet njeri i mirë, dhe kush ndjek të kundërtën, cilësohet si njeri i lig.
- ◆ Njerëzia në këtë botë kanë lakmi për të shijuar të mirat e kësaj jete që janë të përziera me dëshpërime.

Sqarim: Në lidhje me vjershën e sipërme, këtu poshtë po përmendim dy versete Kuranore dhe fjalën Profetike që thonë:

a-Verset: Mos shpenzoni dhe mos kurseni pa masë.

b-Hani e pini dhe mos shpenzoni tepër.

c-Fjala Profetike: Të kënaqurit me pak (përkortësia) është një thesar i pashteruar.

- ◆ Ka shumë njerëz energjikë e të zotë që nuk iu ndihmon fati, por ka edhe disa që pa asnjë pikë zotësie në jetë kanë shanse të mira dhe u ecën puna mbarë.
- ◆ Ata që u pasuruan në këtë jetë nuk e gjetën me mend, por sasia e pasurisë së tyre ka qenë e caktuar nga destinacioni.

Sqarim:- Në lidhje me vjershën e sipërme kemi edhe fjalën Profetike që thotë: “*Kapaciteti i njeriut është i caktuar paralelisht me mjetet e jetesës së destinuar për të*”.

- ◆ Po të ishte që ushqimi i përditshëm të fitohej me forcë, ushqimin e zogjve do ta merrte skifteri.
- ◆ I qofshin falur Atij Zotit të gjithësisë që ushqen të mirin dhe të ligun.
- ◆ Po të ishte që jetesa e njerëzisë të fitohej me forcë, ty nuk do të takonte asnjë qerpiç më tepër nga ajo që të ka caktuar Zoti.
- ◆ Pashë kohën që ndryshon vërtitjen e jetës, dhe në këto ndryshime nuk ka vazhduar as besimi, as hidhërimi.
- ◆ Shumë mbretër ngrehin godina e pallate në këtë botë, po nuk u mbeti shenjë as mbretërve e as pallateve.
- ◆ Të gjitha dobitë e kësaj jete janë fantastike, sepse edhe gëzimi i njeriut të lumtur nuk është i qëndrueshëm.
- ◆ Ju thoni atyre që na përbuzin të vinë në vete se fatkeqësitë e kësaj jete vërtiten.

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)

Nga Kurani Qerim...

(Vazhdon nga numri i kaluar)

SURETU ALI IMRAN

*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit,
Mëshirëbërësit!*

- ♦ Elif, Lamë, Mimë.
- ♦ Allahu është Një, e nuk ka të adhuruar (Zot) pos Tij, është i përjetshëm mbikëqyrës.
- ♦ Ai ta zbret ty (Muhammed) librin me argumentet që është vërtetues i librave të mëparshëm. Ai e zbriti më parë Tevratin dhe Inxhilin.
- ♦ Udhërrëfim për njerëz, e zbriti edhe Furkanin (dalluesin e së vërtetës nga gënjeshtria). S'ka dyshim se ata që mohojnë argumentet e Allahut i pret ndëshkimi i rreptë. Allahu është ngadhënjyes, shpagimtar.
- ♦ S'ka dyshim se Allahut nuk mund t'i fshihet asgjë në tokë e as në qiell.
- ♦ Ai është që ju krijon (formon) juve në mitra ashtu si të dojë. S'ka Zot pos Tij, e që është fuqiplotë i urti.
- ♦ Ai është që ta zbriti librin ty dhe që në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e librit, e ka të tjerë që nuk janë krejtësisht të qartë (muteshabih). E ata që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejtë e qartë për të shkaktuar hut, kinse kërkojnë komentin e tyre. Po, pos Allahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë: "Ne u kemi besuar atij (atyre që janë të paqarta), të gjitha janë nga Zoti ynë! Por, këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të zotët e mendjes.
- ♦ "Zoti ynë mos na i lako zemrat tona pasi na drejtove, na dhuro mëshirën Tënde, pse vetëm Ti je dhuruesi i madh".
- ♦ "Zoti ynë Ti je Ai që një ditë do t'i tubosh njerëzit, ditë për të cilën nuk ka dyshim. Allahu nuk shkel premtimin e vet. **
- ♦ Është e vërtetë se atyre që nuk besuan nuk do t'u vlejë asgjë para Allahut, as pasuria e as fëmijët e

tyre. Ata vetë janë lëndë e zjarrit.


- ♦ Si gjendja e pasardhësve të faraonit dhe e atyre që ishin para tyre, që përgënjeshtroan argumentet tona, e Allahu i shkatërroi me fajet e tyre, Allahu ndëshkon shumë ashpër.
- ♦ Thuaju atyre që nuk besuan: "Do të jeni të mposhtur (në këtë jetë) dhe do të hidheni në xhehenem. Sa i shëmtuar është ai djep (shtrat).
- ♦ Ju (Jehudi) patët një përvojë të madhe në ato dy grupet që u konfortuat ndërmjet vete. Njëri grup luftonte në rrugën e Allahut, e tjetri ishte pabesimtar, dhe me shikimin e syve të tyre i shihnin se ishin dy herë më shumë se besimtarët. Po, Allahu me ndihmën e vet përforcon atë që do. Vërtetë, në këtë është një përvojë e madhe për ata që kanë mendje të kthjelltë.*
- ♦ Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, ndaj djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj botë, po tek Allahu është e ardhmja më e mirë.
- ♦ Thuaj: "A t'ju kumtoj për diç shumë më të mirë se ato (kënaqësitë e dynjasë)? Për ata që janë ruajtur, ata kanë tek Zoti i tyre xhenetin nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe aty do të jenë përgjithmonë, kanë edhe bashkëshorte të pastra, e gëzojnë edhe kënaqësinë e Allahut. Allahu është i kujdesshëm për robët".
- ♦ Ata të cilët thonë: "Zoti ynë, ne sinqerisht besuam, na i fal mëkatet tona na ruaj prej ndëshkimi të zjarrit!"
- ♦ Dhe ata që janë të durueshëm, të drejtë, të devotshëm e dorëdhënës, dhe të cilët në kohën e agimit (syfyrin) kërkojnë ndjesë.
- ♦ Allahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe engjëjt edhe dijetarët, dhe se Ai është

zbatues i drejtësisë. Nuk a Zot përveç Tij fuqiplotit e të Urtit.

- ♦ Feja e pranueshme tek Allahu islami, e atyre që u është dhënë libri, pasi mësuan për të vërtetën, vetëm nga zilia mes vete kundërshtuan. E kush mohon argumentet e Allahut, le ta dijë se Allahu shpejt do t'i japë llogarinë.
- ♦ E, nëse ata polemizojnë me ty, ti thuaj: "Unë me tërë qenien time i jam dorëzuar Allahut, e edhe ithtarët e mijë!" E thuaju edhe atyre që u është dhënë libri dhe injorantëve: "A pranuat fenë islame?" Nëse pruan islam, atëherë e kanë gjetur të vërtetën, e nëse refuzojnë, ti ke për obligim vetëm t'u komunikosh; Allahu i di shumë mirë punët e robëve.
- ♦ Ata që mohojnë argumentet e Allahut, mbysin pejgamberët pa farë të drejte, mbysin edhe njerëz që këshillojnë për të drejtën, ti ata lajmëroi për një ndëshkim të dhembshëm e pikëllues.
- ♦ Ata veprat e tyre i asgjësuan në këtë botë dhe në botën tjetër, ata nuk kanë ndonjë mbrojtës.
- ♦ A nuk i sheh ti ata, të cilëve u është dhënë mjaft nga libri, kur thirrën që ndërmjet tyre të gjykojë libri i Allahut, se si një grup prej tyre prapësohet. Ata janë refuzues.
- ♦ E atë (e bënin) ngase ata thoshnin: "Neve nuk do të na djegë zjarri për pak ditë të numëruara, e ajo që shpifën për fenë e tyre, i mashtroi keq.
- ♦ E, si do të jetë gjendja e tyre kur Ne do t'i tubojmë ata një ditë, për të cilën nuk ka dyshim dhe çdo njeriu do t'i ofrohet ajo që e ka fituar, duke mos iu bërë atyre kurrgjë e padrejtë.
- ♦ Thuaj: "O Allah, Sundues i çdo sendi, Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do, e lartëson atë që do dhe përul atë që do. Çdo e mirë është vetëm në dorën Tënde, vërtetë, Ti ke mundësi

për çdo gjë!"

- ♦ Ti e fute natën në ditë dhe Ti e fute ditën në natë, Ti nxjerr nga i vdekuri të gjallin dhe Ti e begaton pas masë atë që do!"
- ♦ Besimtarët të mos i miqësojnë mosbesimtarët, e ti lënësh manash besimtarët. E kush bën atë, ai nga feja e Allahut nuk ka asgjë, përveç nëse është për qëllim ruajtja prej të keqes së tyre. Allahu ju tërheq vërejtjen me dënimin prej Tij, pse vetëm tek Allahu është e ardhmja.
- ♦ Thuaj: "Dhe nëse e fshehin atë që keni në zemrat tuaja ose e publikoni, Allahu e di atë, Ai di gjithçka ka në qiej e çka në tokë; Allahu është i plotfuqishëm për çdo send.
- ♦ Ditën kur çdo njeri e gjen pranë vete atë që veproi mirë ose keq, e për atë të keqe që e bëri, do të dëshiroj që në mes tij dhe në mes të asaj të jetë një distancë shumë e madhe (e mos ta shohë). Allahu u jep të frikësohen prej dënimit që vjen prej Tij, megjithëqë Allahu është i mëshirshëm ndaj robërve.
- ♦ Thuaj: "Nëse e doni Allahun atëherë ejani pas meje që Allahu t'ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është që falë shumë, mëshiron shumë".
- ♦ Thuaj: "Binduni Allahut dhe të dërguarit, e nëse ata refuzojnë, atëherë Allahu nuk i do pabesimtarët!"
- ♦ Allahu e zgjodhi (pejgameber) Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit, familjen e Iranit mbi popujt e tjerë (të asaj kohe).
- ♦ Që janë pasardhës njëri prej tjetrit. Allahu dëgjon gjithçka dhe i di të gjitha.
- ♦ (Përkujtohu) Kur gruaja e Imranit pat thënë: "Zoti im, unë këtë që është në barkun tim, vendosa ta kushtoj thjesht vetëm në shërbimin Tënd, pra pranoje këtë prej meje, vërtet Ti je Ai që dëgjon e di!"
- ♦ E kur ajo e lindi tha: "Zoti im, unë linda një femër!" Po Allahu e di më së miri atë që ajo e lindi. E mashkulli nuk është si femra. "Dhe unë e emërtova atë Merjeme, e atë dhe pasardhësit e saj po t'i lë Ty në



mbrojte prej djallit të mallkuar.

- ♦ Zoti i saj e pranoi premtimin e saj ashtu si është më mirë, e rriti me një edukatë të mirë e të plotë dhe e vuri nën kujdesin e Zekerijasë. Sa herë që Zekerijaja hynte në mihrabin (dhomën) e saj gjente tek ajo ushqim dhe thoshte : "O Merjeme, prej nga ty ky ushqim? Ajo i thoshte: "Ai është nga Allahu, se Allahu atë që do, pa masë e furnizon!"
- ♦ Aty në atë moment Zekerijaja e lut Zotin e tij e thotë: "Zoti im, më falë dhe mua nga ana Juaj një pasardhës (fëmijë) të mirë, vërtet, Ti je dëgjues i lutjes!"
- ♦ Duke u falur ai na faltore, engjëjt e thërrasin: "Allahu të përgëzon ty me Jahjanë, që do të vërtetojë fjalën (Isain) e ardhur nga Allahu, e që do të jetë prijës i matur dhe pejgamber nga të dalluarit!" Ai (Zekerijaja) tha: "Zoti im,si mund të kem unë një djalë kur më ka arritur pleqëria dhe shoqja ime shtë beronje (sterile)?" Tha (Allahu): "Kështu, Allahu punon çka të dojë!"
- ♦ Ai (Zekerijaja) tha: " Zoti im, më jepë mua një shenjë!" Shenja jote-tha Ai- është që tri ditë nuk do të mund t'u flasësh njerëzve, pos me gjeste (mimikë), e ti përmende shumë Zotin tënd dhe madhoje mbrëmje e mëngjes!"
- ♦ Përkujto kur engjëjt i thanë: "Oj

Merjeme, Allahu të dalloj ty (me besim e karakter), të pastroi (nga shpifjet e breje) dhe të lartësoi mbi gratë e botës.

- ♦ Oj Merjeme, vazhdoje adhurimin ndaj Zotit tënd, bën sexhde dhe falu për Zotin bashkë me ata që falen!
- ♦ Këto janë nga lajmet e fshehta (të hershme) që po t'i shpallim ty. Ti nuk ishe ndër ta kur hidhnin shortet se kush prej tyre do të bëhej kujdestar i Merjemes, nuk ishe pranë tyre as kur ata ziheshin mes vete.
- ♦ Përkujto kur engjëjt i thanë: "Oj Merjeme, Allahu të përgëzon me fjalën e vet (me lindjen e një fëmijë si rezultat i fjalës së Zotit) emri i të cilit është Mesih, Isa, bir i Merjemes, i famshëm në dynja e ahiret dhe nga të afërmit (e Zotit).
- ♦ E që duke qenë në djep (foshnje) u flet njerëzve, e edhe si i rritur e që është nga të përsosurit.
- ♦ Ajo tha: " Zoti im, si mund të kemi unë djalë e mua s'më ka prekur njeriu (nuk jam e martuar)? Ai (Allahu) tha: "Ja, kështu, Allahu krijon çka të dojë. Kur Ai vendos për një çështje, vetëm i thotë: Bëhu! Ajo menjëherë bëhet.
- ♦ Ai (Allahu) ia mëson atij librin (besimin), urtesinë, Tevratin dhe Inxhilin.
- ♦ Dhe të dërguar të bijtë e israilit: unë kam ardhur nga Zoti juaj me argument, unë nga balta ju bëj diç si shpendi, i fryjë atij dhe ai me lejen e Allahut bëhet shpend, unë i shëroj të verbërit, të sëmurit në lëkur, dhe unë me lejen e Allahut ngjalli të vdekurit: unë ju tregoj për atë që e hani dhe për atë që e deponon në shtëpitë tuaja. Vërtet, kjo është fakt për ju nëse jeni besimtarë.
- ♦ Dhe (kam ardhur) që t'ju vërtetoj Tevratin që e keni para duarsh, t'ju lejoj disa që u ishin ndaluar juve, kam ardhur me argument nga Zoti juaj, pra kini frikë Allahun dhe më dëgjoni mua.
- ♦ Allahu është Zoti i Zotit juaj. Adhuroni Atë; Kjo është rrugë e drejtë!"

(Vijon numrin e ardhshëm)

SHQIPËRIA, VENDI I DERVISHËVE...

Nathalie CLAYER

Bektashinjtë

Tarikati bektashian nuk është përhapur veçse në territorin e Perandorisë otomane (në Anadoll, në vendet ballkanike, në

Kretë dhe në Egjipt), ndryshe nga Urdhrrat e tjera mistike, përhapja e të cilave preku një hapësirë të gjerë gjeografike në botën myslimane. Bektashinjtë u themeluan nga Haxhi Bektash Veliu, Piri i tyre (Zot), që jetoi në shekullin 13. Ai ishte një nga dishepujt e Baba Isakut, udhëheqës i një rebelimi që shpërtheu në 1240. Me pushtimet otomane, tarikati, djepi i të cilit ishte Anadulli qendror, u përhap në vendet ballkanike. Udhëheqësi i dytë i Urdhrit, Ballëm Sulltani (Dimoteka), personalitet që i dha Urdhrit formën e tij të vërtetë dhe organizimin e tij, në fillim të shekullit 16, ishte me origjinë nga kjo zonë e re vendosjeje.

Në territoret e Greqisë, Kretës, Bullgarisë, Jugosllavisë dhe Shqipërisë aktuale, popullsia aderoi me një numër të rëndësishëm në bektashizëm, që u afronte atyre që e dëshironin një islam me karakter popullor dhe u lejonte, veç të tjerash, shumë shpesh të ruanin zakone të krishtera ose para-kristiane.

Në Shqipëri, ky aderim u bë kaq i rëndësishëm sa tarikati aty u kthye në periudhën post-otomane, në një komunitet fetar. Zotërohet një dokumentacion relativisht i bollshëm mbi këtë komunitet, gjë që justifikon një prezantim të detajuar të strukturës së tij dhe të praktikave e shpërndarjes gjeografike të tij.

Por, më parë, duhet të paraqesim në vend të hyrjes, një tablo të shpejtë të asaj që ishte situata e bektashinjeve shqiptarë para vitit 1912.



Studjuesja, Nathalie Clayer


...Në fillim të periudhës post-otomane, d.m.th. në 1912, Urdhri i Bektashinjeve ishte vendosur në Shqipëri mbi baza të shëndosha. Teqetë që ekzistonin atëherë, ishin ndërtuar vonë: duke filluar nga fundi i shek. 18 e në mënyrë më të rëndësishme akoma gjysmën e dytë të shekullit 19, bile edhe në fillim të viteve 1900. Le të kujtojmë shkurt evoluimin, organizimin e sidomos rolin, që ky urdhrë luajti në agim të pavarësisë së vendit. *Shqipëria u bë një rajon i veçantë përhapjeje për urdhrin bektashian.* Në fillim të shek. XX, ky numëronte atje rreth 50 qendra e degë të ndryshme. Rreth

15% e popullsisë u vetë deklarua bektashiane. Përmes faktorëve të përhapjes së përmendur shpesh, veçohet, nga njëra anë përdorimi i propagandës bektashiane nga Ali Pashë Tepelena (1780-1822) dhe nga ana tjetër, "qetësia" e Urdhrit në këto rajone në krahasim me pjesën tjetër të Perandorisë otomane pas vitit 1826. Në këtë epokë, në fakt Sulltan Mehmeti II mori masa radikale për të eliminuar trupat e jeniçerëve dhe urdhëroi paralelisht mbylljen dhe bile shkatërrimin e një pjese të madhe të teqeve bektashiane në Perandori.

Por shpjegimi i vërtetë i përhapjes së jashtëzakonshme të urdhrit në Shqipëri është sigurisht shumë më kompleks, sepse ajo do të intensifikohet sidomos rreth fundit të shekullit 19,

pra mjaft larg nga dy fenomenet e përmendur. Mund të mendohet gjithashtu që dy arsyeve të para, u shtohen të tjera, si p.sh., fakti që niveli modest kulturor dhe shoqëror i popullsisë i përshtatej më shumë Bektashizmit sesa islamit synit; arsyeja më e rëndësishme, mendoj se është që Bektashizmi shqiptar mori, në çerekun e fundit të shekullit 19 një pamje kombëtare shumë të theksuar, që tërhoqi drejt tij një pjesë të madhe të popullsisë së rajoneve jugore. Fillimet e këtij qëndrimi i përkasin kohës së persekutimit që Bektashinjtë pësuan më 1326, që i shtyu të shkëpusin lidhjet e tyre me turqit dhe të luftonin më me forcë se shqiptarët e tjerë myslimanë për krijimin e një shteti të pavarur shqiptar. Megjithatë, lufta e tyre u kristalizua vetëm një gjysmë-shekulli më vonë nën "kërrabën" e vëllezërve Frashëri. Megjithëse duke filluar nga 1878, luajtën një rol veçanërisht shqiptar në kuadrin e lëvizjes së çlirimit kombëtar, bektashinjtë shqiptarë nuk kishin atëherë organizim të vërtetë. Ata vareshin, në fakt, nga organizata qendrore e drejtuar prej Pirevi ("shtëpia nënë") e vendosur në Haxhi Bektashi, në Anadollin qendror pranë qytetit Kershehir. Sipas Xhevat Kallajxhiut sipas një ndarjeje të Perandorisë otomane, në 6 zona të ndryshme gjeografike, e drejtuar secila nga një qendër kryesore, Bektashinjtë që përbënin në këto 6 rajone, kishin si teqe kryesore atë të Sejid Ali Sulltanit, pranë Dimetokës në Trakën perëndimore (d.m.th. aktualisht në Greqi).

Thuhet se, duke u nisur nga kjo qendër, u dërguan misionarët e parë në Shqipëri, në grupe prej tre personash: një baba dhe dy dervishë. Këta nuk kishin kohën dhe mundësinë të ndërtonin teqe. Si rrjedhim qendrat lindën, ndonjëherë jo në afërsi të tyrbes së një prej misionareve. Sidomos krahu i dervishëve beqarë, qendra rrezatuese e të cilëve ishte Dimoteka, u përhap në Shqipëri. Bektashinjtë ishin në fakt të ndarë në shumë "kol" (degë) që ndaheshin sërish në nëndegë, sipas skemës që takohet shpesh në strukturën e tarikateve. Dy "kal-et" kryesorë, ishin nga njëra anë ai Çelebi (që u kundërshtua nga pasardhësit direkt të Haxhi Bektashit; dhe u pasua nga ati tek biri) e, nga ana tjetër, ai i Dede-Babait (që vlerësoi që Haxhi Bektashi nuk kishte pasur pasues të drejtpërdrejtë, dhe që, si rrjedhim nuk pasoheshin nga i ati te biri). Krahu i Dede-Babave ishte gjithashtu i ndarë në dy nëndegë: atë të dervishëve të martuar (mytehil) dhe atë të beqarëve (myxheret), të cilëve iu përkiste pjesa më e madhe e bektashinjve shqiptarë. Nënvizojmë gjithashtu që këta të fundit formonin në të njëjtën



kohë pjesën më të madhe të kësaj nëndege në gjithë perandorinë otomane. Vëmë re që në rajonin kryesor të përhapjes, d.m.th. në Ballkan, një pjesë e madhe e babave (ose dervishëve) ishte me origjinë shqiptare (ose turke, por, mesa dimë, *asnjëherë* me origjinë sllave). Veç kësaj, kur më 1908 shpërtheu në Haxhi Bektashi një konflikt midis Dede-babave e Çelebive, pikërisht në Shqipëri, Dede-babatë u kërkuar ndihmë. Kjo lë të mendojmë natyrisht që krahu i tyre përfshinte shumë shqiptarë. Të dërguarit e tij, Salih Nijazi (me origjinë shqiptare), do të bëhet më 1916 i fundit Dede i Madh i emëruar në Haxhi Bektashi para ndalimit të urdhrave mistike myslimane në Turqi. Deri më 1912, lidhjet ndërmjet Bektashinjve shqiptarë dhe Dedesë së Madh ishin shumë të shpeshta. Ceremonitë gjatë të cilave dervishët shprehnin zotimet e tyre të beqarisë bëheshin gjithnjë në Haxhi Bektashi. Dede-të e rinj mund të emëroheshin baba, kur të ktheheshin në vend. Të shumtë ishin gjithashtu dervishët shqiptarë që qëndronin në vend të babait në një nga teqetë e Ballkanit ose gjetkë. Megjithatë, që nga fundi i shekullit 19 të Bektashinjve shqiptarë

VIJON NË FAQEN 40 >>

ose të paktën të disa mes tyre ishin dukur shenja të një kërkesë për emancipim si ndaj "shtëpisë-nënë" edhe ndaj Turqisë në përgjithësi. Kështu, Mit'hat Frashëri, shkruante për sa i përket xhaxhait të tij, Naim Bej Frashërit (poet i madh i lëvizjes kombëtare dhe vetë bektashi):

"Ai mendohej shumë për t'u mësuar Bektashinjtë, që ne kishim nevojë për një Dede-Baba, prej të cilit Baba, të mund të emëroheshin pa qenë nevoja të ktheheshin në "Pir evi" dhe që ky Dede-Baba duhej të ishte i njohur prej të gjithë Babave të Shqipërisë si kryetar".

Gjithashtu, Faik Bej Konica theksonte në 1909, që për unitetin shqiptar, ishte e nevojshme që Urdhëri i Bektashinjtë të reformohej e të organizohej më mirë.

Kjo dëshirë për emancipim përkoi me lëvizjen e çlirimit kombëtar shqiptar, pra me emancipimin e Shqipërisë përballë Perandorisë Otomane. Ashtu si bashkëpatriotët e tyre nacionalistë, bektashinjtë shqiptarë kishin shpresuar për një moment, gjatë marrjes së pushtetit nga turqit e rinj të fitonin një farë autonomie. Por, shumë shpejt, që në 1909, duke mos parë asnjë përmirësim, ata luftuan kundër qeverisë së re.

Karakteristikat e bektashinjtë shqiptarë

Urdhëri i bektashinjtë është sigurisht para së gjithash një urdhër fetar i karakterizuar prej një rituali, besimi dhe praktike, megjithëse ai ka luajtur ndonjëherë rol historik, politik dhe ekonomik.

Në periudhën otomane, bektashinjtë shqiptarë ndiqnin të njëjtat rregulla (rituale, besime, praktika) si gjithë bektashinjtë e Perandorisë, që i përkisnin të njëjtit krah, d.m.th. atij të Dede-Babave. Kujtojmë që për këtë krah, këto rregulla kanë qenë në pjesën më të madhe të fiksuar në fillim të shekullit 16, prej Pirit të dytë të Urdhrit, Balim Sulltan. Pas vitit 1912, bektashinjtë shqiptarë u organizuan e u ristrukturuan në "komunitet fetar", duke vendosur vetë (rast i vetëm në gjithë tarikatet) statute e rregulla! Janë rregullat, praktikat dhe besimet e kësaj periudhe që do

të paraqitim këtu, pa lënë mënjanë analizën, zhvillimet eventuale në raport me periudhën e mëparshme (gjë që do të ishte e udhës të bëhet edhe në punimet e ardhshme), as përcaktimin e ekzistencës së varianteve ose devijimeve në raport me praktikat dhe ritualet e bektashinjtë të pjesës tjetër të Perandorisë otomane (pikë mbi të cilën unë do të rikthehem në konkluzionin tim).

Shumë autorë janë përqendruar tashmë në mënyrë pak a shumë të thelluar mbi këto pyetje, që kanë të bëjnë me bektashinjtë e Shqipërisë, më i rëndësishmi prej të cilëve ishte J.K. Birge, vepra e të cilit "The bektashi Order of Dervishes (1937¹, 1965²) është shumë e çmuar dhe mbështetet pjesërisht mbi thëniet e babave shqiptarë. Duhet gjithashtu të citojmë në radhë të parë, një artikull të turkologut italian E. Rossi, titulluar "Credenze ed usi dei Bektasci", që u publikua më 1942. Autorë të tjerë, si Degrand, Hasluck, Babinger, japin gjithashtu informacione interesante. Së fundi, në vitet 1950 një




orientalist shqiptar, Osman Myderrizi, publikoi disa artikuj me rëndësi mbi literaturën bektashiane shqiptare. Ne duhet para së gjithash, të krahasojmë informacionet e dhëna nga këta autorë për statutet e komunitetit bektashian shqiptar që ne njohim, me burimin që përbëjnë thëniet dhe shkrimet e Baba Rexhepit dhe të rrethit të tij.

Për të paraqitur gjërat qartë, unë do ta ndaj këtë kapitull në 9 pika, që u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme: 1) Cila është hierarkia në gjirin e komunitetit? 2) Cili ishte profili i "itinerarit personal" të një bektashiu? 3) Cili ishte procesi i trashëgimisë së babave për të njëjtën qendër? 4) Cili ishte informacioni dhe niveli i njohjes së pjesëtarëve të "klerit"? 5) Cilat ishin besimet e bektashinjtë të Shqipërisë? 6) Cili ishte rituali i tyre? 7) Cilat ishin praktikat e tyre? 8) Ka pasur literaturë bektashiane shqiptare? 9) Cilat ishin sendet dhe zakonet e praktikuara?...

**Pjesë nga libri i Nathalie Clayer, "Shqipëria, vendi i dervishëve...", Paris 1990*

Poezi bektashiane

Atdheut...



Naim FRASHËRI

O Atdhe! Më je i dashur sa më s'ka,
Më je nënë, më je motër, më je vëlla.

Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti më je,
Je më 1 miri nga çdo gjë që ka ky dhe.

Ty për ditë të pat' parë ime nënë,
Dheu yt në fund atë e pati ngrënë.

Nëmëruar t'i pat lulet, syri i saj,
Te ti lindi, te ti vdiq ajo pastaj.

Ti ke parë gjysh-stërgjyshërit e mi,
Edhe eshtrat tretur, ua ke po ti.

Nga ti, shpirt-o, ata kurrë s'qenë ndarë,
Pranë teje patën qeshur, patën qarë.

Nëna ime vdiq, ndaj ty të kam sot nënë,
Nënë që s'ke vdekje kurrë, faqehënë.

Dhe, pse ha, o dhe, ti bijt' e tu të mjerë,
Numri prapë në vend mbetet kurdoherë.

Begatoje, o imzot këtë vend,
Epo njerëzve të tij, mbroth e shend.

Hi u bëfshin gjithmonë; armiqt e tij,
Gaz për jetë patin zotërit e tij!

I begatë, i lulëzuar qoftë ai,
Një të ardhme pastë, me lumturi!

Në rrugën e bektashisë...



**Gjysh
Bektash
KOZELI**

Ky është fakir Gjysh Bektashi,
Nga djemt' e Shqipërisë,
Ky bëhet theror si dashi,
Në rrugën e bektashisë.

Ky është fakir Gjysh Bektashi,
Shërbëtor i Evlijasë,
Ky bëhet theror si dashi,
Pë fushën e Qerbelasë.

Ky është fakir Gjysh Bektashi,
Me një besë si të vdesë,
Ky bëhet theror si dashi,
Për Hysejnë e Fatimesë.

Ky është ai që i ka pushtuar,
Djemt' e Muhamet Alisë,
Lufton dhe ka luftuar,
Me kombin e Jezidisë.

Thirr o Gjysh Bektash i mjerë,
Ku ke pjesë dhe dëshirë,
Mos u hiq nga ajo derë,
S'ka në botë më të mirë.

**Marrë nga "Kopshti i Shpirtit" i Gjysh
Bektash Kozelit (Fq. 220-221)*

Të pandarë...



**Baba Meleq
SHËMBËRDHENJI**

Kështu lipset të kuptojmë,
Shqiptarët këto fjalë,
Këtë punë ta punojmë,
Gjuha shqipe në shesh t'u dalë.

Unë u le porosinë,
Shoku shokut mos i ndahen,
Që ta zgjojnë Shqipërinë,
Me këtë udhë të mbahen.

Qysh u bë kjo punë vallë,
Pa dashur unë largonem,
M' është bërë mendja dhallë,
Së largu po dëshëronem.

Shumë kohë kanë shkuar,
Syt' e mijë që nuk e shohin,
Vallë s'ma kanë treguar,
A u plaknë e se njohin.

Ohi m'u këput zemra ime,
S' pandeh Perëndia t' thotë,
Të qaj unë me lëngime,
E të bredh jashtë në botë.

Gjuhës shqipe unë si ndahem,
Me gurë të më trazojnë,
Do të punoj sa të çahem,
E në varr të më mbulojnë.

Unë pluhur do t'i bëhem,
Ati vendit të bekuar,
E si druja do t'i gdhendem,
Sa të vdes duke punuar.

Në mos vafsha dot' i gjallë,
Të vdekur të më dërgojnë,
Shqipërisë t'i nxjerr mallë,
E brenda të më mbulojnë.

Trupi në më qoftë tretur,
Dhen e varrit të më ngrënë,
Eshtrat në kanë mbetur,
Në Shqipëri të mi shpjenë.

Me të qarë kështu s'i delet,
Merr hekur lidh kokën tënde,
Djali s' ëmës përkëdhelet,
Ti je nën të huaj vende.

Në dhe të huaj i mjerë
Meleq buza t' është pjekur,
T'u bë loti det në rërë
Mëmëdheu të ka djegur.

FATHER HEKURAN NIKOLLARI PASSED AWAY. THE FAREWELL CEREMONY, TOOK PLACE IN THE TEKKE OF ALIPOSTIVAN-PËRMET

By Nuri ÇUNI

On February 3, 2025, in the tekke of Alipostivan-Përmet, Father Hekuran Nikollari passed away. The reception and homage were held on February 4-5, 2025, in the tekke of Alipostivan. The funeral took place on Thursday, February 6, 2025, at 12:00, also in the tekke of Alipostivan, Përmet.

CEREMONY

With the presence of hundreds of Bektashi believers, clerics, from Albania, North Macedonia and Kosovo, MPs, state and local officials, under the leadership of the World Bektashi Grandfather, Hajji Dede Baba, Edmond Brahimaj, on Wednesday afternoon, in the Tekke of Alipostivan-Përmet, was held the funeral ceremony of father Hekuran Nikollari to his final resting place. This ceremony was preceded by two days of tributes to the deceased cleric. After the greeting of the World Bektashi Grandfather, Dede Edmond Brahimaj, who prepared and led this ceremony, the Minister and MP Mirela Kumbaro, the Mayor of Përmet Municipality, Alma Hoxha; the Mayor of Këlcyrë Municipality, Klement Ndoni; Qerim Zenuni, a relative of the deceased, also give their speech.



Leader of Bektashi World Headquarters, DEDE EDMOND BRAHIMAJ

In the name of God, the Merciful! Dear brothers, fathers, dervishes, myhibs, lovers of Bektashism, believers of the Alipostivan tekke, Frashër, the entire province of Përmet, believers from all over Albania and abroad, dear myhibs, friends, relatives, spiritual sons and daughters of father Hekuran Nikollari. Dear participants, representatives of central and local institutions, at this funeral ceremony, in honor of father Hekuran Nikollari! I thank

you on behalf of the World Bektashi Headquarters for the honors you are paying on this sad day for everyone, in the loss of a simple cleric in appearance and life, but very dedicated, to believers, people in need, Bektashism and who dedicated his life to this holy and difficult path!

The World Bektashi Headquarters and all Bektashi believers have been in mourning since the evening of February 3, when father Hekuran passed away! This sudden departure left a sadness, pain and emptiness for all of us. But his work, this tekke, these believers will forever keep the echo of kindness, respect, hospitality, devotion, patriotism and spiritual warmth. The tekke of Alipostivan, the tekke of Frashëri, were rebuilt from the ruins of communism by the tireless work and dedication of the Baba, so beloved not only in this region but throughout Albania. Today, Bektashism lost a precious man, a diligent and hardworking cleric, with a deep sense of patriotism and dedication.

Baba Hekuran Nikollari, was born on September 7, 1963, in Seniçan, Përmet. He grew up through hardships, but with the great love of his parents, who gave him honesty, kindness, education, wisdom and love for Albania. In 2000, he returned to his homeland

after emigrating. He was brought back by the national consciousness, patriotic and Bektashi ideas of Dede Reshat Bardhi and Baba Ali of Alipostivan. In Seniçan, he rebuilt the Mekam, in the place called "Ahuri i Nakove", which is today called "I miri i Nakove". On March 22, 2001, he went to Alipostivan. The tekke was destroyed in 1967. On April 4, 2002, after staying for a short time near the Holy See in Tirana, Haxhi Dede Reshat Bardhi donned the Bektashi uniform and was appointed dervish, in the tekke of Ali Horasani of Alipostivan, in Përmet. In the years 2007-2009, Baba Hekurani was appointed and served as a dervish in the tekke of Frashëri, which he rebuilt, preserving the originality of the monument of history and culture of this famous tekke, which today is a true miracle. For several years, Baba Hekurani served in the Kulmak Tomorr tekke. Hekuran Fejzo Nikollari, who with the Holy Decree No. 7 dated 29.12.2009 of the World Grandfather of the Bektashis, Saint Haxhi Dede Reshat Bardhi, was given the title of 'Baba' and was appointed father of the tekke of "Baba Nasibiu" in Frashëri, of the tekke of "Baba Aliu" in Alipostivan and of the



tekke of "Baba Xhaferi" in the city of Përmet.

Baba Hekurani of the tekke of Frashëri, Alipostivan and Përmet closed every ceremony with the words "Long live Albania"! Baba Hekurani has been awarded the title of "Honorary Citizen" by the Municipal Council of Poliçan; The title "Honor of Frashëri", by the Council of the Municipality of Frashëri, (Decision No. 19 dated 21.03.2015) and by the President of the Republic, with the "Naim Frashëri Golden Order". With his tireless work, he managed very well the tekke of Alipostivan, Frashëri and made great efforts to build the tekke of Baba Xhaferi in Përmet. With his authority

and devout cleric, he has won the admiration, respect and love of all believers and well-wishers of Përmet and beyond. He has identified all the tekkes, tombs and good places in Përmet, and raised from the foundations the tekke of Cfrat in Bual of Përmet with a wonderful shrine. His work is a special contribution to Bektashism. My brother Baba Hekuran! In my name, of the World Bektashi Leader and the millions of Bektashis who you served with such dedication, gratitude and wisdom, you dedicated yourself with unparalleled zeal to the re-establishment of the Bektashi Tekes, Bektashism and believers, and rekindled faith in God in the hearts of thousands of Bektashi believers in the most difficult time! The work of re-establishing the Bektashi Tekes of Alipostivan, Frashëri, Craft, in Albania will remain immortal in the hearts of all believers. Bektashism physically lost an important and weighty figure, but it is rooted in the history of its holy path, a mystical cleric very dear to everyone! Eternal is your memory, Baba Hekuran, and immortal is your holy work! May your soul rest in peace! May God bless us all! Amin!



Translated by:
Shelda AGARAJ-JANO

1446-1447 hixhri

[illegible][illegible]





KRYEPALATA
BETRIKTESHË E SHKOLLËS
Sëfë e Shqipërisë

All Riza Dade
(1876–1964)
Në post 1914–1964



DHJETOR 2025

e hënë	e martë	e mërkurë	e enjte	e premte	e shtunë	e diellë
1	2	3	4	5	6	7
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

1 shkurt – Dhjetorin e kalonim Turpindorin 1985.
21 janar – (15-gjener) Hapimemori i mësimit të Mërkurësorin –
 Hapimemori i shpirtit të vitit 1985.

28 shkurt – Rada e Mërkurës së parë.
28 dhjetor – (28-gjener) Dhjetorin e kalonim Turpindorin 1985.
 dhjetorin e kalonim Turpindorin 1985.